

VETERANI

GAZETË PERIODIKE. NR.7(433)

KORRIK 2024

ÇMIMI: 30 LEKË

Drejtor: MUHARREM GJOKA; Kryeredaktor: HALIL RAMA; Zv/Kryeredaktor: SAKIP CAMI & BASHKIM HISARI; website: www.VETERANIOBVL.ORG

KOMENT



PASQYRIMI I VEPRIMTARISË SË OBVL NË GAZETËN "VETERANI"

SHPENDI TOPOLLAJ

FAQE 5

VLERËSIMI



MBROJTJA E VLERAVE TË LANÇ, KYÇI I SUKSESEVE TË OBVL NË 30 VITE

Prof. Asoc. Dr. Bernard Zotaj

FAQE 6

75 VJETORI



ARKIVI QENDROR SHTETËROR INSTITUCION QË FRYMËZON E PROMOVON

FAQE 16

Një enciklopedi me portrete të më shumë se 100 personaliteve të shquara, ish komandantë e drejtues të LANÇ, burgosur e internuar nga sistemi i diktaturës

30 VJET OBVL

HISTORI SUKSESI

Halil RAMA

Organizata e Bashkuar e Veteranëve të Luftës Antifashiste Nacionalçlirimtare të popullit shqiptar (OBVL), më 18 korrik 2024 mbush 30 vjet nga krijimi i saj.

Në tri dekada aktivitet intensiv, OBVL u dëshmuar para shqiptarëve si Organizata që vlerëson lart kontributin e shquar të popullit shqiptar në Luftën e Dytë Botërore, që dënon krimet e komunizmit, që mbështeti fort Luftën e drejtë të UÇK dhe në tërësi çështjen mbarëkombëtare shqiptare.

Me këtë rast, me librin "30 VJET OBVL", botim i redaksisë së gazetës "Veterani", kemi synuar të pasqyrojmë gjërësisht dhe në detaje, pa pretenduar se kemi thënë gjithçka, punën e madhe të mbi 15 mijë veteranëve e pasardhësve të tyre, që milituan deri në vdekje dhe militojnë edhe aktualisht në këtë organizatë, në të mirë të demokracisë shqiptare dhe të së ardhmes së brezave, duke pasqyruar sa më drejt këtë luftë vigane që e renditi Shqipërinë në krahun e fitimtarëve të Luftës së II-të Botërore.

Në 80 vjetorin e çlirimit të atdheut dhe 30 vjetorin e OBVL, ky libër modest është një kontribut për të njohur të kaluarën e lavdishme, për të vlerësuar të sotmen dhe për të projektuar të ardhmen.

"30 VJET OBVL - HISTORI SUKSESI" është libri që pasqyron orientimin e drejtë të kësaj organizate dhe veprimtarinë e gjallë të saj. Në të ka përshkrime të disa jetëve njerëzore, por gjithësesi primare është vetëdija dhe besimi i veteranëve dhe pasardhësve të tyre, anëtarë të Organizatës sonë, jo vetëm në Luftë por edhe në Demokraci. Ky liber, në vetvete dëshmon faktin se organizatat dhe shoqatat politike, shoqërore, atdhetare kulturore etj, janë asete të rëndësishme, janë pasuri e kësaj shoqërie.

VIJON NË FAQEN 2



E krijuar para 30 vitesh me nismën e një grupi prej 64 personalitetesh, gjeneralë dhe luftëtarë, figura politike të respektuara, por fatkeqësisht të dënuar nga regjimi komunist, Organizata e Bashkuar e Veteranëve të Luftës së Popullit Shqiptar (OBVL) do të bëhej promotore e mbrojtjes së vlerave tona kombëtare. Në këtë grup bënë pjesë figura politike të respektuara që kishin qenë drejtues të reparteve partizane, ministra e zv/ministra....

FAQE 2,3,4

KONFERENCA SHKENCORE

Sami Frashëri ideologu i shquar i Rilindjes Kombëtare

Muharem Kamani

FAQE 15

STUDIMI



PETRO ZHEJI: "SHQIPJA ËSHTË MËMA E TË GJITHA GJUHËVE"

Xhemal MEÇI & Halil RAMA

FAQE 14

KOMENT

NJË ÇEREC SHEKULLI NGA ÇLIRIMI I KOSOVËS

Nga Bashkim Hisari

FAQE 12

HOMAZH

LAMTUMIRË FLUTURAK VINÇANI

Nga MAKSIM VINÇANI, Nënkryetar i OBVL

FAQE 9

PROFILI

KARRIERA E SUKSESSHME E MEHDI LUCËS NË INSTITUCIONET DHE NDËRMARRJET E DIBRËS

FAQE 8

DITELINDJA E 89-TË

XHEMAL MEÇI, HISTORIANI I MADH I QYTETIT TË VOGËL

Nga IDRIZ AHMETAJ

FAQE 13

IN MEMORIAM

17 VJET NGA IKJA E SYTKI HOXHËS

Hasan DOMI

FAQE 10

NDERIMI

NJË SHKOLLË ME EMRIN E VETERANIT TË ARSIMIT SKËNDER KUTA

Nga MEVLUD BUCI

FAQE 11

SPECIALE

Një enciklopedi me portrete të më shumë se 100 personaliteve të shquara, ish komandantë e drejtues të LANÇ, burgosur e internuar nga sistemi i diktaturës

30 VJET OBVL, HISTORI SUKSESI



Nga Halil RAMA – Mjeshtër i Madh*

(vijon nga fq. 1)

Pjesë e kësaj pasurie është edhe OBVL si organizatë shoqërore atdhetare..

Në këtë libër tanimë OBVL ka të dokumentuar punën e vet, ka të dokumentuar shpirtin e vet, ka të dokumentuar ambicjen e vet.

“30 VJET OBVL – HISTORI SUKSESI”, është pothuajse një enciklopedi me portrete e profile të më shumë se 100 personaliteve të shquara, ish komandantë e drejtues të LANÇ, të ekzekutuar, burgosur e internuar nga sistemi i diktaturës hoxhiste, të shkundur tashmë nga pluhuri i harresës dhe të evidentuar me tërë aktivitetin patriotik në dobi të atdheut të tyre.

OBVL U KRIJUA NGA 64 PERSONALITETE, ISH-DREJTUES TË LANÇ, TË USHTRISË SHQIPTARE E STRUKTURAVE TJERA QEVERITARE

Rënia e Murit të Berlinit në nëntor 1989 dhe ndryshimet demokratike në Evropën Lindore u reflektuan edhe në Shqipëri me përmbysjen e diktaturës komuniste, duke sjellë ndryshimin e sistemit shoqëror dhe kalimin në demokracinë e bazuar në pluralizmin partiak dhe sigurimin e lirisë së njeriut.

Por, drejtuesit e shtetit të ri mbetën politikanët me prejardhje nga diktatura komuniste, më e egra në Evropën Lindore dhe rrjedhimisht qeverisja e re nuk mund të ishte plotësisht demokratike. Në këto kushte veteranët e luftës që nuk kishin marrë pjesë në krimet e PPSH dhe Enver Hoxhës, u mblodhën para 30 viteve (korrik 1994) dhe krijuan Organizatën e Bashkuar të Veteranëve të Luftës (OBVL), që kishte për qëllim të mbështeste proceset demokratike dhe shtetin ligjor dhe t'i bashkonte veteranët e Luftës Antifashiste Nacional Çlirimtare të popullit shqiptar në një organizatë të vetme, për të ruajtur më mirë traditat e luftës dhe të drejtat e tyre.

Kësisoj, e krijuar para 30 vitesh me nismën e një grupi prej 64 personalitetesh, gjeneralësh dhe

luftëtarësh, figura politike të respektuara, por fatkeqësisht të dënuar nga regjimi komunist, Organizata e Bashkuar e Veteranëve të Luftës së Popullit Shqiptar (OBVL) do të bëhej promotore e mbrojtjes së vlerave tona kombëtare. Në këtë grup bënin pjesë figura politike të respektuara që kishin qenë drejtues të reparteve partizane, ministra e zv/ministra, siç ishin: Dr. Ymer Dishnica, gjeneral Rrahman Parllaku, gjeneral Nexhip Vinçani; Sadik Bekteshi (gjeneral lejtant - Hero i Popullit), gjeneral Muhamet Prodani, Skënder Malindi, Edip Ohri, Kiço Ngjela, Manol Konomi, Fadil Paçrami, Maqo Çomo, dhe Ernest Jakova; luftëtarët e shquara, drejtues në luftë e aktiviste të OBVL: Selfixhe Broja(Ciu), Zenepe Golemi (Ashiku), Liri Belishova, Vera Ngjela (Pojani) e disa të tjera, por fatkeqësisht të dënuara nga regjimi diktatorial i Enver Hoxhës.

Organizata e Bashkuar e Veteranëve të Luftës së Popullit Shqiptar (OBVL) është një organizatë shoqërore atdhetare. Ajo u formua që të vlerësojë realisht historinë e luftës së lavdishme Nacional Çlirimtare, që të shmangë shtrembërimet e periudhës së regjimit totalitar, mohimet dhe politizimet e bëra si rezultat i regjimit diktatorial të E.Hoxhës, por edhe me qëllim të caktuar nga individë që kërkonin lavdi dhe pushtet të pamërituar. Në kurthin e tyre ranë me dëshirë dhe me servilizëm historianë të ndryshëm që e shtrembëruan historinë e LANÇ.

Organizata e Bashkuar e Veteranëve të LANÇ u shtri rrufeshëm në gjithë Shqipërinë. U krijuan dhe u konsoliduan degët tona në rrethet si vijon: Në Tiranë me kryetar z.Muhamar Spahiu, Korçë, me kryetar Z.Haxhi Runi, Elbasan me kryetar



GRUPI NISMËTAR PËR FORMIMIN E OBVL-së

1.Andon	Sheti
2.Ali	Butka
3.Alfred	Moisiu
4.Bedri	Shehu
5.Dashmir	Ohri
6.Delo	Balili
7.Edip	Ohri
8.Ernest	Jakova
9.Elami	Hado
10.Guri	Shyti
11.Haki	Jupasi
12.Hamid	Keçi
13.Hysni	Daja
14.Irakli	Bozo
15.Islam	Blushi
16.Janaq	Budina
17.Josif	Zegali
18.Kiço	Ngjela
19.Koço	Qafzezi
20.Muhamet	Prodani
21.Masar	Shehu
22.Mentor	Belegu
23.Myfit	Guxholli
24.Manol	Konomi
25.Myftar	Tare
26.Nurie	Bozo
27.Nexhip	Vinçani
28.Ndreçi	Plasari
29.Nexhat	Iljazi
30.Pertef	Myftari
31.Petrit	Malindi
32.Rrahman	Parllaku
33.Skënder	Godo
34.Sami	Hadëri
35.Sami	Vinçani
36.Sotir	Budina
37.Sitki	Bushati
38.Koço	Leshnja
39.Kole	Jakova
40.Lavdosh	Dulaj
41.Muhsin	Kroi
42.Myzafer	Mati
43.Mato	Hasamataj
44.Muhamer	Spahiu
45.Shefqet	Mezini
46.Sheraf	Gjebrea
47.Taqo	Adhami
48.Tahir	Voshtina
49.Tanush	Shyti
50.Vangjel	Babi
51.Selfixhe	Broja
52.Sazan	Xhelo
53.Skënder	Malindi
54.Seit	Berisha
55.Shkëlqim	Zaloshnja
56.Shaban	Reçi
57.Shemsi	Sadiku
58.Vangjel	Priftanji
59.Vera	Pojani
60.Xhavit	Qesja
61.Ymer	Dishnica
62.Zenepe	Ashiku
63.Zekie	Voshtina
64.Nexhmi	Balika

z.Sami Vinçani, Durrës, me kryetar z.Idriz Hoxha, Shkodër me kryetar z.Muharrem Bushati, Lushnjë me kryetar.z.Iliaz Ahmeti, Krutë me kryetar z.Fadil Veseli; Lezhë me kryetar z.Loro Gjeçi, Tropojë me kryetar z.Hamit Neziri; Fier me kryetar z.Nazif Ago, Mat me kryetar z.Ismail Muharremi, si dhe në të gjitha rrethet e vendit.

Vlen të përmendet kontributi i veteranëve Fluturak Vinçani (Korçë), Genc Ballanca (Durrës), Osman Xhindoli (Shijak), Jorgji Terca (Tiranë), Xhemal Meçi (Pukë), Agim Dylgjeri(Elbasan), Ali Demushi(Shkodër) etj.

Tre vitet e fundit OBVL ka riorganizuar degët e saj në qarqet kryesore, si Tiranë, Durrës, Elbasan, Shkodër e Dibër, në drejtimin e të cilave janë zgjedhur personalitete të njohura publike, si ish – ushtaraku Mazllum Parllaku (Tiranë); publicist dhe shkrimtari i mirënjohur Shpendi Topollaj (Durrës), studjuesi Ali Demushi me karrierë të gjatë si officer shembullor (Shkodër) mësuesi veteran, shkrimtari dhe publicist Mevlud Buci (Dibër) etj.

(Vijon në faqen 3)

SPECIALE

• E krijuar para 30 vitesh me nismën e një grupi prej 64 personalitetesh, gjeneralë dhe luftëtarë, figura politike të respektuara, por fatkeqësisht të dënuar nga regjimi komunist, Organizata e Bashkuar e Veteranëve të Luftës së Popullit Shqiptar (OBVL) do të bëhej promotore e mbrojtjes së vlerave tona kombëtare. Në këtë grup bënin pjesë figura politike të respektuara që kishin qenë drejtues të reparteve partizane, ministra e zv/ministra, siç ishin: Dr. Ymer Dishnica, gjeneralët: Rrahman Parllaku, Nexhip Vinçani, Sadik Bekteshi e Muhamet Prodani; Skënder Malindi, Edip Ohri, Kiço Ngjela, Manol Konomi, Fadil Paçrami, Maqo Çomo, dhe Ernest Jakova; luftëtarët e shquara, drejtues në luftë e aktivistë të OBVL: Selfixhe Broja(Ciu), Zenepe Golemi (Ashiku), Liri Belishova, Vera Ngjela (Pojani) e disa të tjera, por fatkeqësisht të dënuara nga regjimi diktatorial i Enver Hoxhës

(Vijon nga faqja 2)

KATËR PERSONALITETE TË OBVL-SË “NDERI I KOMBIT”

Pikërisht për rolin që ka luajtur, si mbrojtëse dhe promovuese e vlerave më të mira kombëtare shqiptare, Organizata e Bashkuar e Veteranëve të Luftës së Popullit Shqiptar (OBVL) është ndër organizatat më të vlerësuara nga institucionet shtetërore, me katër personalitete “Nderi i Kombit”. Me këtë titull të lartë të akorduar nga ish-presidentët Nishani e Meta janë vlerësuar dy kryetarët e parë të OBVL: Dr. Ymer Dishnica e gjeneral Rrahman Parllaku, si dhe gjeneralët Nexhip Vinçani e Veli Dedi.

Ish – kryetari i OBVL, gjeneral Rrahman Parllaku, është dekoruar me titullin “SIMBOLI I QYTETIT TË TIRANËS” nga Kryetari i Bashkisë Tiranë, Z. Erion Veliaj, si dhe me titullin “QYTETAR NDERI” i Qarkut Kukës, “Qytetar Nderi” i Bashkisë Shijak dhe i ish -komunës Kurvelesh.

Ndërkohë, me “Dekoratën e Artë të Shqiponjës” janë dekoruar ish-themeluesit dhe drejtuesit ndër vite të kësaj organizate: Ish-nënkryetari dhe kryetari i saj, kolonel Myfit Guxholli, ish-sekretari i Përgjithshëm Edip Ohri dhe anëtarët e kryesisë: Liri

30 VJET OBVL, HISTORI SUKSESI



Belishova e Hamit Keçi. Po ashtu, me propozimin e OBVL ju është akorduar “Dekorata e Artë e Shqiponjës” komandantit të Çetës së parë Partizane të Gollobordës, patriotit të madh me rrezatim mbarëkombëtar Ahmet Cami, si dhe ish-kuadrit të Brigadës së 18, Ismail Bara. Në 10 vitet e fundit janë dekoruar me titullin “Mjeshtër i Madh” drejtuesit aktualë të OBVL: Sekretari i Përgjithshëm, akademik Halil Rama, nënkryetari Muharrem Gjoka dhe kryetari i Degës së OBVL Pukë, studiuesi dhe shkrimtari i mirënjohur Xhemal Meçi.

TRI RRUGË NË TIRANË ME EMRAT E PERSONALITETEVE TË OBVL

Gjerdanit të artë të vlerësimeve për personalitetet e OBVL-së iu shtua dy vitet e fundit edhe emërtimi i tri rrugëve të Tiranës me emrat e gjeneral Rrahman Parllakut, Liri Belishovës dhe Edip Ohrit. Kështu, në konsiderim të propozimit të Kryesisë së OBVL, Këshilli i Bashkisë Tiranë, me Vendimin nr. 55, datë 1.6.2020 ka vendosur që rruga te Tregu Agroushqimor (pranë shkollës jopublike “Sarina” të emërtohet Rruga “Edip Ohri”, ndërsa me vendimin nr. 137, datë 05.10.2020 ka vendosur që segmenti rrugor që bashkon rrugën “Ali Demi” me rrugën “Petro Nini Luarasi” të emërtohet rruga “Gjeneral Rrahman Parllaku”, si dhe rruga që nis nga rreth rrotullimi i “Astir”-it të emërtohet rruga “Liri Belishova”. Kësisoj, përjetësohen tre personalitete të organizatës tonë, me kontribute madhore gjatë Luftës së Dytë Botërore, në krijimin dhe konsolidimin e Ushtrisë e të Shtetit Shqiptar si dhe për themelimin e drejtimin me përkushtim të rrallë të OBVL-së.

ANËTARE E FEDERATAVE EUROPIANE DHE BOTËRORE TË VETERANËVE

Me një aktivitet intensiv në mbrojtjen dhe promovimin e këtyre vlerave, dr. Dish-

nica dhe gjeneral Parllaku arritën ta bëjnë OBVL-në anëtare të Federatave Evropiane dhe Botërore të Veteranëve. Me pjesëmarrjen në aktivitetet e këtyre Federatave, jo vetëm në Evropë, por edhe në Malajzi, në Johannesburg, Marok etj, OBVL-ja ka bërë të njohur kontributin e popullit shqiptar në Luftën e II-të Botërore dhe në luftërat për liri të popullit tonë në Kosovë, Maqedoni e deri dhe kontributin që jep sot në mbrojtje të paqes në kuadrin e NATO-s. Nisur nga ky aktivitet intensive dhe vlerat që mbron e promovon, OBVL vlerësohet për orientim e drejtë, për veprimtarinë e gjallë të saj, për vetëdijen dhe besimin e veteranëve dhe pasardhësve, anëtarë të organizatës, jo vetëm në luftë, por edhe në demokraci.

OBVL DHE ORGANIZATA E VETERANËVE TË LANÇ TË KOSOVËS NË NJË FEDERATË TË PËRBASHKËT

Në një aktivitet të rëndësishëm në kuadrin e 14-vjetorit të pavarësisë së Kosovës (14 shkurt 2022) u finalizua krijimi i Federatës Shqiptare të Veteranëve të Luftës së Popullit të Popullit Shqiptar. Kështu, pas një pune intensive gati trevjeçare, OBVL e Shqipërisë, trashëguese e denjë e themeluesve dhe drejtuesve të saj: Dr.Ymer Dishnica – “Nderi i Kombit” e gjeneral Parllaku- “Hero i Popullit” e “Nderi i Kombit” dhe Organizata e Veteranëve të LANÇ të Kosovës, e themeluar dhe drejtuar nga Heroi i Popullit FADIL HOXHA-ARKITEKT I KOSOVËS SË LIRË, finalizuan krijimin e kësaj federate.

Fokusi i saj, në përbërje të të cilës janë Organizata e Veteranëve të LANÇ të Kosovës dhe OBVL të Shqipërisë, do të jetë edukimi atdhetar i rinisë, nisur nga tradita shekullore e popullit shqiptar, nga përvoja dhe programet e Federatave Botërore e Evropiane të Veteranëve, si dhe në pikëpamjet e përbashkëta programore, të fokusuara në organizimin e veprimtarive të përbashkëta për: mbrojtjen e vlerave

(Vijon në faqen 4)



SPECIALE

30 VJET OBVL, HISTORI SUKSESI

(Vijon nga faqja 3)

historike të popullit tonë nëpër shekuj; evidentimin dhe promovimin e ngjarjeve dhe datave historike; përkujtimin e datave të kuvendeve historike shqiptare, si Kuvendi i Lezhës, Lidhja e Prizrenit, Pavarësia e Shqipërisë, Konferenca e Pezës, Konferenca e Bujanit, Pavarësia e Kosovës etj.

Po ashtu, Federata do të fokusohet në përkujtimin e ditëlindjeve jubilarë të heronjve, dëshmorëve, prijësve e komandantëve legjendarë të luftërave të popullit tonë, për liri e pavarësi kombëtare si dhe në kontributin për progresin e demokracisë e konsolidimin e shtetit ligjor në dy shtetet tona: Shqipëri dhe Kosovë. Pas miratimit të marrëveshjes për krijimin e Federatës Shqiptare të Veteranëve në kryesinë përkatese, dy organizatat respektive u bënë ftese publike për aderimin në të edhe organizatave e shoqatave të tjera të veteranëve në Shqipëri, Kosovë e Maqedoninë e Veriut.

MBROJTËSE E FLAKTË E VLERAVE TË LIRISË

OBVL, veteranët dhe pasardhësit e tyre, anëtarë të kësaj organizate ndjehen më krenarë se kurrë me historinë e saj të suksesshme 30 vjeçare dhe angazhohen për të ecur në shembullin e themeluesve, që organizata jonë të vazhdojë të funksionojë si

mbrojtëse e flaktë e vlerave të lirisë.

Mbrojtja, propagandimi, ruajtja, mbajtja gjallë e vlerave të historisë sonë kombëtare, e veçanërisht atyre të LANÇ-it, dhe transmetimi i tyre te brezat pasardhës është dhe mbetet qëllimi themelor i OBVLsë.

Në këtë vit jubilar të 80-vjetorit të çlirimit të Atdheut, ne ndjehemi më krenarë se kurrë për faktin që Shqipëria gjatë Luftës së Dytë Botërore u vendos në anën e antifashistëve, fitimtarëve, dhe frontit të madh të lirisë, meritë kjo e partizanëve shqiptarë, këtyre kalorësve të çlirimit dhe të lirisë.

Organizata e Bashkuar e Veteranëve të Luftës (OBVL) në 30 vjet veprimtari ka përmbushur misionin e saj historik, të ruajtjes, mbrojtjes e zhvillimit të vlerave të Luftës, nga më të lavdishmet për liri e pavarësi të shqiptarëve në trojet e tyre etnike në Ballkan, të luftës Antifashiste Nacionalçlirimtare kundër pushtuesve fashistë italianë e nazistëve gjermanë. OBVL u themelua me përmbysjen e sistemit diktatorial enverian në përputhje me frymën e përpjekjeve për bashkim të shqiptarëve, shprehur në Konferencën e Pezës dhe Marrëveshjen e Mukjes, me program e statut gjithëpërfshirës. Ajo dha një kontribut të çmuar gjatë këtyre tri dekadave të periudhës së tranzicionit të brishtë, ende të papërfunduar në RSH.

OBVL përfshiu në radhët e saj ushtarakë e veteranë të OUPLSH, të organizatave demokratike të

veteranëve, shtresa veteranësh jashtë tyre dhe kreu veprimtari në lëvrimin e vlerave, të traditës e të legjislacionit, në dobi të veteranëve, të invalidëve e familjeve të dëshmorëve si dhe në hartimin e legjislacionit për këto shtresa.

OBVL, në veprimtarinë e saj u distancua nga sistemi totalitar i partisë-shtet. Ajo shtriu bashkëpunimin e saj me të gjitha shtresat, pa paragjykuar bindjet e tyre; me ata që përkrahën luftën, e mbështetën atë dhe e ndihmuan, e që sot ende nuk përfaqësohen me organizata të veçanta. OBVL ka njohur shtetin ligjor; ka bashkëpunuar me institucionet e pavarura të tij dhe ka ndërmarrë nisma në dobi të veteranëve, invalidëve e familjeve të dëshmorëve.

Në veprimtarinë e saj OBVL nderoi kontributin e të përndjekurve politikë, sidomos të atyre të LANÇ e të ushtarakëve të spikatur që udhëhoqën luftën, por që padrejtësisht u pushkatuan, u burgosën, u dëbuan e internuan.

Gazeta "Veterani", organ i OBVL pasqyroi dhe pasqyron vazhdimisht veprimtarinë e kësaj organizate dhe ka ndihmuar në realizimin e objektivave dhe detyrave të saj. Përveç 434 numrave të gazetës "Veterani" në këto 30 vjet, të shumta kanë qenë botimet e librave të veteranëve, të cilat jemi përpjekur ti promovojmë si në Shqipëri ashtu edhe në Kosovë.

OBVL, në bashkëpunim me Organizatën e Veteranëve të LANÇ të Kosovës, ka përgatitur dhe promovuar bujshëm edhe dy dokumentarët: "Rrahman Parllaku - Një legjendë në kufirin e tri kohëve" dhe "Fadil Hoxha - Arkitekti i Kosovës së lirë", dokumentarë këto që janë shfaqur si për publikun në sallën e Akademisë së Shkencave Tiranë dhe nga Radio Televizioni Publik Shqiptar (RTSH).

Në këtë 30-vjetor OBVL vjen e konsoliduar, e bashkuar dhe me energji e vendosmëri për të lëvruar më tej, pasuruar më shumë historinë reale të LANÇ dhe për të dhënë kontributin e saj real për konsolidimin e demokracisë e të shtetit ligjor, për një Shqipëri anëtare e denjë e NATO-s që ecën vendosmërisht drejt anëtarësimit në Bashkimin Europian.


Halil RAMA

***Sekretar i Përgjithshëm i OBVL**



KOMENT

PASQYRIMI I VEPRIMTARISË SË OBVL NË GAZETËN “VETERANI”



SHPENDI TOPOLLAJ

Qysh kurse u themelua 30 vjet më parë OBVL, iu kushtua një vëmendje e veçantë organizimit dhe funksionimit të gazetës së saj, ku do të shpërfaqej si qëllim kryesor idetë, opinionet e synimet, ashtu edhe gjithçka do të realizohej gjatë gjithë aktivitetit të saj. Gazeta, u gjet e arsyeshme të quhej “Veterani” edhe pse në përbërje të kësaj organizate do të inkuadroheshin edhe anëtarë të rinj, të cilësuar si pasardhës veteranësh, ç’ka do të siguronte vazhdimësinë e saj. Historikisht, misionin e gazetave, qysh kur ato u shfaqën fillimisht aty nga shekulli i XV - të dhe sidomos pas zhvillimit që morën nga viti 1700, askush nuk e ka përcaktuar më mirë se Joseps Pulitzeri i cili thosh se “Një gazetë që i rri besnike qëllimit të vet, merret jo vetëm me mënyrën se si janë gjërat, por edhe se si duhet të jenë”. Por, natyrisht që ecuria e gazetarisë në kohë nuk ka qenë e njëtrajtëshme, pasi krahas shumimit të saj, interesave të grupeve të caktuara, nevojës për fitime, propagandës shtetërore dhe shërbimit politik, të cilat e forcuan rolin e saj deri sa e quajtën pushtet i katërt, kanë sjellë pa fund mendime, përkufizime, lëvdata e kritika të ashpra, aq sa edhe Honore Balzaku i quante ato “armë në duart e partive”. Ky përcaktimi i fundit, më mirë se kudo u pa gjatë viteve të gjata të komunizmit në vendin tonë, ku fjala e lirë dhe e vërteta të përcaktuara nga norvegjezi Henrik Johan Ibsen si kollonat e shoqërisë, u përdhosën deri në pëshqirosje. Përmbysja e atij regjimi, solli mundësinë për të krijuar tashmë në demokraci, forca politike, shoqata, organizata e grupime të çfarëdoforme, pra atë që e etiketuam si pluralizëm, nga e cila lindën edhe gazetatat e lira si përfaqësuese të ideve, platformave dhe opinioneve të gjera.

Në këtë kuadër krijimi i OBVL - së, nga luftëtarë të vjetër si Heroi i Popullit Rrahman Parllaku, zonja Liri Belishova, Dr.Ymer Dëshnica, Sadik Bekteshi, Muhamet Prodani, Edip Ohri, Maqo Çomo, Manol Konomi, Kiço Ngjela, Fadil Paçrami, Nexhip Vinçani, Ernest Jakova, Skënder Malindi, Gjergj Titani, Xhemal Ymeri, Myfit Guxholli, Sotir Budina e plot të tjerë, e pati të domosdoshme pasjen e një gazete. Ajo



do të ishte mjete që do të shtronte para lexuesve qëndrimet dhe platformat e asaj organizate atdhetare, e cila do të evidentonte luftën e madhe që populli shqiptar bëri për çlirimin e vendit, gjakun që derdhën bijtë dhe bijat e saj, rrugën luftarake të formacioneve partizane, drejtuesit dhe fatet e tyre, ngatërresat politike mes komunistëve dhe nacionalistëve, problemin e bashkimit kombëtar me Kosovën dhe Çamërinë etj. etj dhe gjithçka ngjau pas fitores, kur padrejtësisht goditja e diktatorit ra mbi shokët e tij. Mbi të gjitha, kjo gazetë do të kishte në programin e vet, edukimin e brezave me vlerat e mëdha të asaj lufte, me trimërinë e treguar dhe me nevojën e bashkimit të popullit tonë sot, duke lënë mënjane gabimet e rënda të së shkuarës dhe duke parë më shumë nga e ardhmja.

Mjaft kishim vuajtur nga lufta e klasave, pra nga përçarja. Nuk mund të vazhdohej më gjatë kështu. Romakët e vjetër kishin parimin “Pësimet - mësimet”. Ne ishim dhe jemi vëllezër të një gjaku, me të njëjtën histori, me të njëjtën heronj, me të njëjtën dashuri për Atdheun tonë të shtrenjtë dhe pse jo, me të njëjtën armiq. Ashtu sikurse në këto dekada jemi së bashku në të njëjtën Aleancë ushtarake, në NATO dhe kemi aleatë të njëjtat shtete perëndimore me SHBA në krye. Dhe sa ishte gjallë, këtë e dëshmoi i gjithë qëndrimi i “Nderit të Kombit” të paharruarit Rrahman Parllaku si drejtues i kësaj organizate. Kudo që ai shkoi, kudo që ai foli, kudo që atë e intervistuan dhe në gjithë artikujt e shumtë që janë të botuara në gazeta, apo librat që

shkroi, kishte vetëm një fjalë: dashurinë për njëri - tjetrin, pra të shqiptarit për shqiptarin. Dhe ishte fat që si kryeredaktor i kësaj gazete të caktohej një intelektual, gazetar dhe shkrimtar me përvojë, kulturë dhe reputacion si Halil Rama i cili me urtësi ka ditur prej shumë vitesh të zgjedhë bashkëpunëtorët dhe ta ruajë të pastër në artikujt e shumtë, frymën e asaj organizate.

Falë këtij qëndrimi, gazeta “Veterani” ka përcaktuar sistematikisht paqen mes nesh, evidentimin e vlerave të larta, ngjarjet me rëndësi kombëtare, stigmatën ndaj asaj që ndodhi, ngritjen e zërit për padrejtësitë dhe krimet që ju bënë popullit të Kosovës, pasqyrimin e luftës trimërore të UÇK, demaskimin e pa ndërprerë të qëndrimeve dashakeqe të Serbisë me Aleksandar Vuçiqin në krye. Po ashtu, në faqet e saj ajo i ka kushtuar një rëndësi edhe përhapjes së kulturës të lexuesit, duke nxjerrë në pah vlerat dhe përfaqësuesit më në zë të saj. Gazeta “Veterani”, si organi i vetëm i OBVL, gjithmonë ka kërkuar edhe shkrirjen në një të dy organizatave, pra bashkimin e saj me atë të LANÇ, pasi nuk shihej asnjë arsye për të qenë të ndarë. Ajo e ka kërkuar këtë me sinqeritet të plotë, me dashamirësi dhe pa asnjë ndikim partiak, qoftë edhe për të dhënë një shembull sesi mund të bashkëpunohet edhe sot kur ndarjet janë bërë modë.

Sipas qëndrimit parimor të organizatës, në gazetën “Veterani” asnjë shenjë inati nuk mund të gjendet edhe ndaj dikujt që mund të verë në dyshim këtë kërkesë e cila tek e fundit është në shërbim të vendit tonë. Seneka, shpërfilljen ndaj fyerjeve e ka quajtur diçka tipike për shpirtrat fisnikë, ndaj anëtarët e kësaj organizate nuk i zemërohen askujt. Për të gjithë ata që kanë pasur fatin të shfaqin mendimet dhe qëndrimet e tyre në këtë gazetë të nderuar ka vlejtur konstatimi i drejtuesit të Institutit Konstruktiv, danezit Ulrik Haagerup i cili mëson te se “...duhet të jemi pushteti i tretë mes qeverisë dhe opozitës, duhet të përpiqemi të jemi të paanshëm. Ne duhet të jemi miku më i mirë i publikut”. Veteranët e organizatës dhe pasuesit e tyre, në të gjitha veprimtaritë e zhvilluara e kanë dëshmuar me pjekuri se mbi të gjitha është Shqipëria.

Këtë ka pasqyruar në faqet e saj edhe kjo gazetë, që ashtu si vetë OBVL ka mbetur faktor pajtimi, mirëkuptimi e bashkëpunimi, të cilës do t'i qëndrojnë besnikë edhe në të ardhmen.



VLERËSIMI

Mbrojtja e vlerave të LANÇ, kyçi i sukseseve të jetës dhe veprimtarisë së OBVL në 30 vite



Prof. Asoc. Dr. Bernard Zotaj
Mjeshtër i Madh

LUFTËTARËT QË KRIJUAN ORGANIZATËN

Në shekuj populli shqiptar ka luftuar dhe ka bërë përpjekje të vazhdueshme për dinjitet, pavarësi, liri dhe demokraci. Grumbullimi i këtyre principeve parimore morën vlera dhe u ngritën në shkallën më të lartë në vitet e LANÇ-it.

Lufta e drejtë për çlirim dhe liri e bërë nga luftëtarët shqiptarë në Luftën e Dytë Botërore bëri që Shqipëria të rreshtohet me plot dinjitet në Koalicionin e Madh Antifashist Botëror, ku dha kontribut dhe shfaq vlera, si një vend që u përball me dy Fuqi të Mëdha pushtuese të kohës dhe doli fitimtar duke çliruar vendin me forcat e veta.

Luftëtarët e kësaj lufte, me ardhjen e demokracisë në Shqipëri, më 18 korrik 1994 krijuan Organizatën e Bashkuar e Veteranëve të Luftës të popullit shqiptar (OBVL), për të mbajtur gjallë frymën atdhetare, përpjekjet dhe sakrificat e popullit dhe bijve të tij, si dhe për të përkujtuar dhe transmetuar në breza këtë përvojë të madhe. Rrënjët e luftës dhe të antifashizmit shqiptar u shfaqën në Luftën e Spanjës ku dhe morën përmasa në fillimet e rezistencës popullore shqiptare më pushtimin fashist të vendit.

Luftëtarët e kësaj lufte, 30 vite më parë, personalitete, gjeneralë dhe partizanë, figura politike të dënuar nga regjimi komunist, u mbledhën dhe formuan Organizatën e Bashkuar të Veteranëve të Luftës së Popullit Shqiptar me mision mbrojtjen e vlerave të kësaj lufte.

Ata ishin: Dr. Ymer Dishnica, gjeneral Rrahman Parllaku, gjeneral Nexhip Vinçani; Sadik Bektoshi (gjeneralletenant - Hero i Popullit), gjeneral Muhamet Prodani, Skënder Malindi, Edip Ohri, Kiço Ngjela, Manol Konomi, Fadil Paçrami, Maqo Çomo, dhe Ernest Jakova; gratë luftëtare Selfixhe Broja (Ciu), Zenepe Golemi (Ashiku), Liri Belishova, Vera Ngjela (Pojani) etj.

Këta i kanë dhënë hov dhe jetë kësaj organizate që veteranët e luftës, duke qenë përfaqësuesit më besnikë e luftëtarë trima të patrembur, që i kushuan jetën e tyre çlirimit të Shqipërisë. Në këtë periudhë shkruan kujtime të kësaj epopeje duke pasuruar memorien kombëtare me dokumente kryesore e të rëndësishëm për brezat e ardhshëm.

ORGANIZATËN E KRIJUAN DHE E DREJTUAN FIGURA HISTORIKE

Organizata është udhëhequr dhe drejtuar nga figura të spikatura atdhetare, por dhe me kontribute të mëdha të dhënë prej tyre gjatë luftës. Vend kryesor zënë figurat ushtarake të luftës, komandantët e komisarët e brigadave dhe të njëjve sulmuese. Për punën në mbrojtje dhe promovim të vlerave të luftës në këto vite, të jetës së organizatës janë vlerësuar personalitete me titullin “Nderi i Kombit”, si ish kryetarët Dr. Ymer Dishnica, ish anëtar i Shtabit të Përgjithshëm; gjeneralletenant Rrahman Parllaku, ish komandant Divizioni Sulmues; gjeneral Nexhip Vinçani, ish komandant i Br. IVS, si dhe antifashisti i Luftës së Spsnjës dhe gjeneral, Hero dhe ushtarak madhor Veli Dedi.

Me dekoratën e “Artë të Shqiponjës” janë vlerësuar kolonel Myfit Guxholli; ish-sekretari i Përgjithshëm i organizatës Edip Ohri dhe anëtarët e kryesisë Liri Belishova e Hamit Keçi, si dhe komandanti i Çetës së Parë Partizane të Gollobordës, patrioti Ahmet Cami dhe ish-kuadri i Br. XVIII S Ismail Bara.

Nga kjo organizatë për përkushtim në mbrojtje të vlerave të luftës, me titullin “Mjeshtër i Madh” janë dekoruar: Sekretari i Përgjithshëm dhe Kryeredaktori i gazetës “Veterani”, akademik Halil Rama; nënkryetari i Organizatës Muharrem Gjoka dhe kryetari i Degës Pukë, studiuesi dhe shkrimtari i mirënjohur Xhemal Meçi.

Në përkujtim dhe nderim të figurave të organizatës, Këshilli i Bashkisë së Tiranës ka emëruar disa rrugë në qytetin e Tiranës me emrat e Rrahman Parllakut, Liri Belishovës dhe Edip Ohrit. Përvetësohen kështu personalitete të organizatës, me kontribute të dukshme në Luftën e Dytë Botërore, në krijimin, organizimin dhe konsolidimin e Ushtrisë Partizane dhe të Shtetit Shqiptar, por dhe për udhëhqjen me përkushtim të organizatës. Rrahman Parllaku, Hero i Popullit, Nderi i Kombit dhe gjeneral, ka bërë histori, është një legjendë e jetuar

në tri kohë. Në rrugëtimin 100-vjeçar, ai ka ngelur një monument dhe simboli i qytetit të Tiranës, një kujtesë atdhetare, qytetare dhe historike. Liri Belishova, luftëtarja grua që ishte në udhëheqje në LANÇ dhe të pasluftës. Edip Ohri është bërë legjenda e armës së Aviacionit Shqiptar dhe mbetet një figurave madhore e Forcave të Armatosura.

PUNË PLOT PËRKUSHTIM NË 30 VITE

Në këto 30 vite të jetës dhe veprimtarisë të kësaj organizate, luftëtarët dhe pasardhësit e saj, me punën dhe përpjekjet e tyre për mbrojtjen e idealeve të shenjta të LANÇ-it, kanë të drejtë të krenohen për vlerat e shfaqura dhe të mbrojtura me dinjitet. Në këto vite jete të saj, ka punuar dhe luftuar për mbrojtjen e vlerave luftarake të popullit, gjakun dhe sakrificat e luftëtarëve të njëjve partizane, të dëshmorëve e heronjve të rënë dhe të simboleve të tyre. Në këto 30 vite, organizata ka manifestuar vlera dhe percjellë mesazhe fisnikërie për kontributin e luftëtarëve gjatë zhvillimit të Luftës Antifashiste Nacionalçlirimtare të popullit shqiptar në kuadrin e Luftës së Dytë Botërore.

Organizata e Bashkuar të Veteranëve të Luftës me misionin e saj historik mbështeti proceset demokratike të zhvilluara në Shqipëri në fundshekullin e XX, si dhe ndërtimin e shtetit ligjor, duke mbledhur rreth vetes luftëtarë të luftës së madhe, por që pas çlirimit të vendit disa prej tyre në sistemin monist vuajtën në burgje, të dënuar për fjalën e lirë.

Organizata me misionin e saj ka bërë vlerësimin e historisë të luftës së lavdishme Antifashiste Nacionalçlirimtare, të luftëtarëve, të dëshmorëve, të formacioneve partizane, të Shtabit të Përgjithshëm të UNÇSH dhe anëtarëve të shtabit. Organizata nuk ka qenë dhe nuk është dakort me periudhën e diktaturës së proletariatit dhe me Enver Hoxhën, ku janë dhënë dënime dhe bërë persekutime



VLERËSIMI



Mbrojtja e vlerave të LANÇ, kyçi i sukseseve të jetës dhe veprimtarisë së OBVL në 30 vite

të mjaft kuadrove të udhëheqjes, të ushtrisë dhe të sektorëve të tjerë të jetës politike dhe shoqërore.

ORGANIZATË E NJOHUR PËR VLERAT QË PËRCJELL

Me përkushtimin e dr. Dishnicës dhe të Heroit Parllaku, organizata u bë anëtare e Federatave Europiane dhe Botërore të Veteranëve.

Në disa vende të botës, organizata ka bërë të njohur kontributin e popullit shqiptar në Luftën e Dytë Botërore, si dhe përpjekjet e bëra në luftërat për liri dhe pavarësi, për përpjekjet e popullit të Kosovës dhe të shqiptarëve në vendet e rajonit të Ballkanit. Kështu Organizata në këto aktivitete ka mbrojtur vlerat e luftës, ka rritur besimin e veteranëve dhe të pasardhësve, në përpjekjet për demokraci.

OBVL dhe Organizata e Veteranëve të LANÇ në Kosovës, në bashkëpunim kanë krijuar Federatën Shqiptare të Veteranëve të luftërave për liri e pavarësi të popullit shqiptar.

Organizata e Veteranëve të LANÇ në Kosovë dhe OBVL e Shqipërisë, në bashkëpunim me Federatën Botërore Europiane të Veteranëve, po punojnë për organizimin e veprimtarive të përbashkëta në mbrojtjen e vlerave historike të popullit tonë në shekuj; ato kanë evidentuar dhe promovuar ngjarje dhe data historike; kanë përkujtuar data historike të kuvendeve historike si Kuvendi i Lezhës, Lidhja e Prizrenit,

Pavarësia e Shqipërisë, Konferenca e Pezës, Konferenca e Bujanit, Pavarësia e Kosovës etj. Federata gjithashtu është përqëndrar në përkujtimin jubilarë të heronjve, të dëshmorëve, të prijësve e komandantëve legjendarë të luftërave të popullit tonë, për liri e pavarësi kombëtare.

ORGANIZATA KA MBROJTUR VLERAT E LUFTËTARËVE DHE TË DËSHMORËVE

Në jetën 30 vjeçare OBVL ka kryer veprimtari të vijueshme në mbrojtjen dhe promovimin e vlerave të LANÇ. Veteranët dhe pasardhësit e organizatës ndjehen krenarë se në këto tre dekada vite të jetës dhe veprimtarisë, kanë punuar dhe luftuar për mbrojtjen e vlerave të lirisë. Në themel të misionit të saj organizata ka mbrojtjen, propagandimin, ruajtjen dhe mbajtjen gjallë të vlerave të historisë kombëtare, por në veçanti të LANÇ-it, si

dhe transmetim të tyre në breza.

Në 80-vjetorin e çlirimit të Atdheut, veteranët dhe pasardhësit e Organizatës kanë të drejtë të ndjehen krenarë për faktin se Shqipëria në Luftën e Dytë Botërore u rreshtua në anën e antifashistëve, të fitimtarëve dhe të frontit të madh të lirisë. Kjo është meritë e partizanëve, e kalorësve të çlirimit dhe të lirisë, e dëshmorëve që flijuan jetën për këtë Atdhe që jetojmë.

Organizata me veprimtaritë e zhvilluara ka realizuar misionin historik, duke ruajtur, mbrojtur dhe zhvilluar vlerat e LANÇ dhe të luftërave për liri e pavarësi të shqiptarëve në trojet e tyre etnike në Ballkan. Në këto vite ka bërë moto të punës së saj bashkëpunimin me të gjitha shtresat, pa paragjykimë në bindje, përkrah luftën, mbështet dhe ndihmon shtetin ligjor, bashkëpunon me institucione të pavarura dhe ka ndërmarrë nisma në dobi të veteranëve dhe të familjeve të dëshmorëve. Në veprimtarinë e saj organizata ka nderuar kontributin e të gjithë pjesëmarrësve në LANÇ.

OBVL, në rrëgëtimin e saj 30 vjeçar ka patur dhe bashkëudhëtare organin propogandues që pasqyron të gjithë punën dhe përpjekjet në këto vite. Gazeta "Veterani", një gazetë mujore ka pasqyruar në mënyrë dinjitoze veprimtarinë e organizatës dhe ka ndihmuar në realizimin e objektivave dhe detyrave të saj. Në përmbushjen e këtij misioni historik "Veterani" është bërë një udhërrëfyes i dhjetra mijëra veteranëve dhe pasardhësve, anëtarë të organizatës. Gazeta ka mbrojtur në mënyrë dinjitoze luftën e popullit shqiptar, përpjekjet e bëra në rrugën e ndërtimit të socializimit, ka shfaqur qëndrimin dhe mendimet ndaj udhëheqjes së PPSH, për dënimet dhe burgjet ndaj drejtuesëve të luftës dhe të pasluftës etj. Në faqet e saj kanë gjetur pasqyrim mjaft veprimtari të degëve të saj të shtrirë në të gjitha bashkitë e vendit.

Organizata në 30 vjet ka bërë dhe botime të librave të veteranëve, të cilat janë promovuar në mënyrë dinjitoze në Shqipëri dhe në Kosovë. Organizata gjithashtu ka përgatitur dhe promovuar dokumentarët "Rrahman Parllaku, një legjendë në kufirin e tri kohëve" dhe "Fadil Hoxha, arkitekti i Kosovës së lirë".

Në këtë 30-vjetor organizata ka një bilanc të pasur me veprimtari dhe përkujtimore të ngjarjeve të luftës, të veprës së partizanëve dhe të aktit heroik të rënies së dëshmorëve, me përpjekje për organizimin dhe gjallërim të jetës së saj. Organizata dhe anëtarësia e saj, ka punuar me pasardhësit për njohjen e historisë, për përpjekjet dhe luftën e partizanëve dhe heroizmin e dëshmorëve, për njohjen e rrugës luftarake të njëjësive partizane dhe të drejtuesëve të tyre, etj.

Urime organizatës për mbrojtjen dhe pasqyrimin e vlerave të LANÇ në rrugëtimin e saj historik, veteranëve dhe pasardhësve, gjithë forumeve të saj, si dhe gazetës "Veterani" për lartësimin e kësaj epepeje të madhe të popullit shqiptar, siç ishte Lufta Antifashiste Nacionalçlirimtare!



PROFILI

Rrugëtimi i vështirë me urtësi, trimëri e sakrificë mençurore i ish - sekretarit organizativ të Rinisë antifashiste të krahinës Reç e Dardhë

KARRIERA E SUKSESSHME E MEHDI LUCËS NË INSTITUCIONET DHE NDËRMARRJET E DIBRËS

Halil RAMA – Mjeshtër i Madh

Në plejadën e 800 nxënësve të Internatit të njohur të Kastriotit (1925-1939) nga Shqipëria verilindore, të cilët më vonë dhanë një kontribut të çmuar në shërbim të kombit, në fusha të ndryshme të jetës së vendit, bën pjesë edhe Mehdi Islam Luca nga Tartaj i Zall Dardhës.

Në vitin 1934 në këtë fshat erdhi një bursë studimi për Aqif Kacën për të ndjekur shkollën fillore të Kastriotit, por meqë familja e tij nuk pranoi, fati e solli që atë ta merrte Mehdi Luca. Kjo, falë ndërhyrjeve të babait të tij largpamës, Islamit, me të gjitha mundësitë që kishte, te kryeplaku i katundit, në parinë e vendit e deri te kryetari i komunës në Kraj Reç, që aso kohe ishte Ahmet Salija nga Burgajeti i rrethit të Matit.

Kështu e nis rrugëtimin për arsimim e dije Mehdi Luca i datëlindjes 14.07.1925, kur ishte vetëm 9 vjeç, për ta përfunduar shkollën fillore 5-vjeçare në harkun kohor të pesë viteve (1934-1939) me rezultate të shkëlqyera. Dhe si shumë të rinj nga kjo shkollë që rrokën armët në luftë kundër fashizmit, edhe Mehdi Luca do të ishte ndër nismëtarët e organizimit të rezistencës në krahinën e Dardhës.

I frymëzuar nga 25 të rinj të kësaj shkolle që dhanë jetën për çlirimin e atdheut si: Heroi i Popullit Nazmi Rushiti dhe dëshmorët Tofik Çanga, Demir Gashi, Riza Doda, Besim Imami, Tasim Shehu, Abdi Kazani, Rifat Kaloshi e të tjerë, Mehdi Luca, në fillim të vitit 1944, kur u ngrit Organizata e Rinisë Antifashiste në krahinën Reç - Dardhë, u zgjodh Sekretar Organizativ për këtë krahinë, detyrë të cilën e kreu me përkushtim deri pas çlirimit të vendit.

Në librin e tij me kujtime "Baba Islam" (faqe 74), ndër të tjera Mehdi Luca evidenton aktivitetin e dalluar të asaj organizate, shokët e tij të rinisë: Maliq Troci, Hazis Elezi, Rufat Sufa, Rexhep Troci, Liman e Sali Hoxha, Bajram Ndreu, Halil Xhediku, Ramadan Braka, Avdi Kaca, Hamit Çera, Haxhi Çera e të tjerë. Në këtë libër ai shkruan edhe për inspektorët e Rinisë të rrethit Dibër, që mbanin lidhje me organizatën e Rinisë të krahinës Reç-Dardhë që ai drejtonte, të cilët ishin: Bitro Tase (që u mbyt në Drin të Zi në Zall Dardhë, duke kaluar lumin); Esma Agolli, Sadush Baholli, Kozma Vjera etj, që kalonin në këmbë ditën e natën, në shi e borë, gjithë krahinën për të kryer detyrat e ngarkuara për rininë.

"Ndër to, detyrat më kryesore ishin: të shtohen radhët e brigadave partizane me të rinj, veçanërisht për ato brigada që kalonin nëpër zonën tonë. Të siguronim strehim për brigadat partizane që kalonin andej. Të rritej propaganda për brigadat partizane, forcën e tyre kundër fashizmit dhe përkrahësve të tyre. Këto detyra i kryem deri në fund të çlirimit dhe

• Mehdi Islam Luca ishte ndër burrat e urtë e të mençur të odave e mexheliseve, të cilat përbënin shkallën më të lartë intelektuale të popullit të krahinës së Dibrës, për të zgjidhur probleme, që edhe drejtësia moderne do t'i kishte lakmi për mençurinë e përdorur nga "pleqtë", që ndanin kuvendet, bashkonin njerëzit, pajtonin gjaqet, zgjidhnin problemet e pronës, u jepnin të drejtë njëjës palë, pa marrë parasysh rrangun a ofiqin që kishte pala tjetër



ishim nga organizatat më të dalluara në rrethin e Dibrës", - shkruan Mehdi Luca në kujtimet e tij.

Mbas çlirimit ai punoi në Komitetin e Rinisë të rrethit si përgjegjës sporti e fiskulture nga viti 1948-1949 me shokët e shoqet, Fiqiri Aliu - Sekretar i Komitetit të Rinisë, Fadil Asllani, Shazimet Asllani etj.

Dy vitet në vijim (1949-1951) kryen me përgjegjësi detyrën e punëtorit operativ në Degën e Punëve të Brendshme, me shokët Hazis Asllani, Izet Hasani, Sami Kamberi e të tjerë.

Si edhe dhjetra dibramë të tjerë që kishin studjuar në Internatin e Kastriotit dhe që kishte mbaruar edhe Shkollën e Mesme Ekonomike në Tiranë, Mehdi Luca do të ishte shembull i kuadrit të devotshëm në sektorë të rëndësishëm. Ai ishte ndër të parët Përgjegjës Fiskulture e Sporti në Komitetin e Ekzekutiv të Rrethit Dibër (1951-1953), ku në saj të një pune intensive u ngritën mbi 50 kolektiva sportivë në gjithë fshatrat fushorë e kodrinore dhe sporti mori një gjallëri të madhe edhe në ndeshjet me rrethe të tjera, si në futboll, volejbol etj.

Përvojën e fituar në këtë sektor të rëndësishëm do ta implementonte edhe në Kooperativën e Kombinuar të Artizanatit Peshkopi si nënkryetar e kryetar i saj (1953-1956), për të vijuar po dinjitetshëm e suksesshëm si Shef Seksioni për investime, transport dhe ambalazh në Bashkimin e Kooperativave të Konsumit Peshkopi në vitet 1956-1959; si zëvendëskryetar dhe shef prodhimi në kooperativën e Artizanatit "23 Gushti" Peshkopi (1959-1961) dhe për tetë vite të tjera (1961-1969) si shef plani në Ndërmarrjen e Shërbi-meve Komunale Peshkopi.



TEFTA CAMI: ME PUNËN ME PASION E PROFESIONALIZËM MEHDI LUCA MBOLLI PEMËN E PAVDEKËSISË

Bashkëkohësit, ndër të cilët do të veçoja Tefta Camin, Elmaz Lalën, artistin e mirënjohur Skënder Cala, Mjeshterin e Madh Muharrem Gjoka, publicistin dhe poetin Shaqir Çerpja, Znj. Hajrie Hajro e Dhurata Pano dhe veprimtarët shoqërorë shembullorë Irfan Zebi e Selim Çerpja, e kujtojnë Mehdi Lucën si kuadrin shembullor e intelektualin e mirëformuar edhe kur shërbeu si shef furnizim-shpërndarje e shef plani në NISH Prodhime Peshkopi (1969-1974). Ishin vitet kur nga kjo ndërmarrje, me prodhimet e frutave si reçelna, komposto etj, plotësoheshin jo vetëm nevojat e vendit tonë, por edhe eksportin në shumë shtete, sidomos komposton, për të cilën kishte shumë kërkesa nga Gjermania, Austria etj.

Ish - Ministria e Arsimit dhe Kulturës, Tefta Cami, e vlerëson Mehdi Lucën si intelektualin e drejtuesin e shquar, si mikun e komshiun fisnik e të kulturuar. "Ruaj kujtime të bukura për të, për dashurinë e mirësinë, që u dhuronte njerëzve, për përkushtimin ndaj familjes e punës, për kujdesin që tregonte ndaj punonjësve e njerëzve në nevojë. Ai shquhej për thjeshtësi dhe mençuri... Mehdi Luca, me punën me pasion e profesionalizëm që bëri, mbolli pemën e pavdekësisë, sepse la një emër të mirë, që do të kujtohet e nderohet për shumë vite nga pasardhësit e tij e të punonjësve, si dhe nga qytetarët dibrane. Familja, fëmijët, farefisi e miqtë duhet të jenë krenarë për jetën e kontributin e madh të tij! U prehtë në paqë!", shprehet Tefta Cami.

Ndërsa Elmaz Lala - ish - Shef i Seksionit të Arësimit e Kulturës në KE të KP të rrethit Dibër e kujton Mehdi

Lucën si: "një burrë i urtë, i kulturuar, model i sjelljes shoqërore, fisnik edhe në paraqitje e komunikim, me pasion për librin, njeri që bënte vetëm miq e te "prisheshe" me të fajin kerkoje te vetja", një qytetar shumë i përgjegjshëm e që respektonte miqtë e deres së tij si pakkush"

Mehdi Luca do ta mbyllte karrierën e tij të një nëpunësi simbol të aftësisë profesionale dhe të një intelektualit me dije e vizion bashkëkohor si shef furnizim - shpërndarje në ish - Ndërmarrjen e Ndërtimit Peshkopi, detyrë të cilën e kreu me devotshmëri e përkushtim të rrallë për 11 vjet (1974-1985) deri sa doli në pension.

Kjo karrierë profesionale dhe kontributi i tij intelektual, e rendisin Mehdi Lucën me elitën dibrane që luajti rol parësor në procesin e formimit të vetëdijes kombëtare dhe rindërtimit të vendit të rrënuar nga lufta Antifashiste Nacionalçlirimtare, jo vetëm në fshatin e tij të lindjes, por në gjithë krahinën Reç e Dardhë, e më gjerë në gjithë rrethin e Dibrës.

Në formimin e tij si intelektual, krahas dijeve të fituar në Internatin e Kastriotit dhe në Shkollën e Mesme Ekonomike Tiranë, ndikoi edhe bashkëpunimi me ish kuadro drejtues e drejtorë me reputacion të ndërmarrjeve të Dibrës, si Ahmet Kaçorri, Shaban Sadja, Kadri Meta, Ahmet Perleka, Faris Reka, Destan Aga, Rahman Çenga etj, të cilët dhanë kontributin e tyre në progresin shoqëror dhe ekonomik të Dibrës.

Gjithashtu, edhe bashkëshortja e tij, Sudja, një zonjë fisnike e me inteligjencë natyrore të rrallë, ka jo vetëm meritën e qëndrimit besnike pranë Mehdiut në çdo etapë të jetës bashkshortore, por edhe të mirërritjes dhe edukimit të fëmijëve.

(VIJON NË FAQEN 9)

HOMAZH

LAMTUMIRË FLUTURAK VINÇANI

MAKSIM VINÇANI

Nënkryetar i OBVL

Më 2 Qershor 2024 u nda nga ne Fluturak Asabella, veterani i LAN, anëtar i kryesisë së OBVL, Kryetar i Degës së Organizatës së Bashkuar të Veteranëve të Luftimeve për liri e pavarësi të popullit shqiptar, për Qarkun e Korçës.

Fluturak Avdyll Asabella lindi dhe u rrit në fshatin Vinçan të Rrëzës së Korçës.

Ishte vetëm 16 vje kur Shqipëria pushtohet nga fashizmi italian, megjithatë e shohim pjesëmarrës në demonstrimet e patriotëve korçarë më 5-6 prill 1939 duke kërkuar armë për rezistencë ndaj pushtuesit. Plot zjarr dhe energji rinore, i rritur dhe edukuar në mjedisin e një familjeje dhe të një fshati me tradita atdeshdashëse ai u vu në shërbim të qen-



dresës antifashiste qysh në fillimet e saj. Në vitet 1942-43, atë do ta gjejmë të plotësisht të përkushtuar ndaj veprimtarisë antifashiste duke



punuar pa u lodhur për përhapjen e frymës për nevojën e rezistencës dhe zgjerimit të rradhëve të njësiteve të armatosura të Rrëzës së Korçës.

Në tetor '43 merr pjesë në formacionet e armatosura të UN. Operacioni armik i Dimrit e gjeti në Br.IVs, ku si gjithë të tjerët iu desh të përballojë vështirësi të jashtëzakonshme të luftimeve, rraskapitjes, të të ftohtit, urisë e pagjumësisë.

Në një betejë me focat naziste në Arzë të Devollit plagoset rrëndë. Mje-

kohet në Slimnicë të Greqisë në spialin partizan të EAM-it, për t'u rikthyer mbas 3 muajsh në formacionet luftarake, tashmë në rradhët e Br. XV's si zv.komisar kompanie deri në lirim.

Fluturaku i përballoi me nder të gjitha detyrat dhe vështirësitë e luftës për 3 vjet. Megjithëse i vdes i ati dhe Fluturaku ishte i vetmi mashkull madhor i familjes, ai nuk e braktisi luftën deri në fund, ku mori gradën n/toger dhe u nderua me një numër

medaljesh e dekoratash. Fluturaku fliste me krenari për pjesëmarrjen në atë luftë, por nuk u pajtua kurrësi me pasojat shkatërruese të Diktaturës të mbas lirim.

Si shumë të tjerë edhe Fluturaku ëndërronte një Shqipëri të pas luftës me mirëqenje, liri, demokraci, paqe dhe harmoni. Fluturaku ishte nga të parët që kuptoi shkeljen e idealeve për të cilat u luftua dhe si guximtar dhe i ndershëm që ishte reagoi duke u shprehur haptazi në një mbledhje të oficerave në Delvinë në verë të vitit 1946. Ai ishte i ndërgjegjshëm për pasojat që mund të kishte, por kurë nuk mund besonte se puna do të shkonte deri aty sa ta arrestonin dhe ta dënonin si armik i popullit.

Me dënimin e Koci Xoxes në 1949 u lirua, por me gjithë përpjekjet e tija të vazhdueshme, si dhe shumë të tjerë, Fluturakun nuk e rehabilituan kurrë. Mbi 40 vjet do ta ndihej i "fyer" e i "poshtëruar" nga kalvari torturonjës prej persekutimit nga Sigurimi famëkq, por ai asnjëherë nuk e lëkundti krenarinë dhe dinjitetin. Edhe pse i lodhur nga mosha dhe tallazet e jetës, ai nuk rreshti së qëni një qytetar aktiv, duke duke kontribuar si Kryetar i OBVL-Korçës, në evidentimin dhe promovimin e vlerave patriotike e morale te popullit shqiptar. Veteranët e OBVL dhe pasardhësit e tyre e vlerësojnë lart Fluturakun dhe ndihen të nderuar që e patën midis tyre.

Familja, bashkëfshatarët, miqtë dhe të gjithë të njohurit, ndihen të pikëlluar për këtë humbje, por janë krenarë për veprën e tij.

Veteranët e OBVL dhe pasardhësit do ta kujtojmë me krenari Fluturakun tonë të dashur, i cili pas disa ditve do të kishte 100-vjetorin e lindjes. Vepra e tij do të mbetet midis nesh.

Maksim VINÇANI
Nënkryetar i OBVL

KARRIERA E SUKSESSHME E MEHDI LUCËS NË INSTITUCIONET DHE NDËRMARRJET E DIBRËS

(Vijon nga faqja 8)

BURRË I URTË E I MENÇUR I ODAVE E MEXHELISEVE

Mehdi Islam Luca ishte ndër burrat e urtë e të mençur të odave e mexheliseve, të cilat përbënin shkallën më të lartë intelektuale të popullit të krahinës së Dibrës, për të zgjidhur probleme, që edhe drejtësia moderne do t'i kishte lakmi për mençurinë e përdorur nga "pleqtë", që ndanin kuvendet, bashkonin njerëzit, pajtonin gjaqet, zgjidhnin problemet e pronës, u jepnin të drejtë njërës palë, pa marrë parasysh rrangun a ofiqin që kishte pala tjetër.

Ai ishte familjar dhe prind shëmbullor. Kishte lexuar shumë e kjo kulturë e fituar nga leximi reflektohet edhe në librin e tij "testament" me kujtime, ku me një gjuhë mjaftë të pasur e mjete shprehëse interesante evidentohet dashuria e pamatë për babë Islam, nënë Hanishen mixhën Sali, bashkshorten Sudan, për fëmijët Kujtime, Ylli dhe Iliri, motrat Sulltana, Xhevahire dhe Mihane..., dhe jo vetëm.

Është ky një libër ku përshkruhet mjeshtërisht gjeografia e vendlindjes, miqtë e shtëpisë së tij (ndër të cilët veçon: Hamit Çerpen, Avdi Lushin, Elez Dervishin, Bajram Muratin, Xheladin Bucin, Dodë Vladin "byrazier", Cen Lekën, Islam Xhedikun, Rustem Gjonin, etj. Po ashtu ai shkruan për Institucionin e "Odës Dibrane" (në

katër shifra me gjuhë alegorike).

I brumosur me ndjenjat e zjarrta të atdeshdashurisë që si bazë ka familjen, Mehdi Luca e personifikon atë edhe me rrugëtimin e vështirë, nga vendlindja Tartaj e Dardhës për t'u strehuar një vit pas martesë me Sudan në një dhomë të vogël private tek shtëpia e Haqif Shehut pas xhamisë Peshkopi, për të vijuar po në një dhomë të vogël rreth 5 m2, tashmë edhe me një fëmijë në rrugicën e ngushtë të Pazarit ku ngjitet rruga për në bulevard të qytetit; pas 3 vjetësh në lagjen Kallavere në një dhomë të shtëpisë së Maliq Xhelilit, ku lindën edhe fëmijët Kujtimja dhe Ylli; në pallatin dy katësh afër PPT; në një pallat tjetër në të majtë të Shkollës së Mesme Bujqësore dhe së fundmi me dy dhoma e një kuzhinë në një pallat katër katësh (i fundit në të djathtë afër Shkollës së Mesme Bujqësore), ku jetuan për 26 vjet, nga viti 1968 deri më 1994, kur e shitën dhe erdhën në Tiranë.

Edhe këtu në metropolin shqiptar, (deri sa u nda nga jeta më 5 nëntor 2018, i përcjellë për në botën e përtejme me të gjitha nderimet që meritonte, nga familja, farefisi, miqtë e shokët e tij të shumtë), Mehdi Luca bëri jetë intensive si veprimtar i shquar shoqëror, frekuentues i librit e shtypit dhe me krijimtari letrare mbresëlënëse, për të cilat na flet me dashuri e mirënjohje, nipi i tij Zyber Gjoni, ish - zv/dekan i filialit të Universitetit të Durrësit në Peshkopi, një përfaqësues dinjitoz i elitës intelektuale dibrane në qytetin e Peshkopisë.

IN MEMORIAM

17 VJET NGA IKJA E SYTKI HOXHËS

Hasan DOMI

Ishite fundi i janarit i vitit 1987. Asokohe fleja në hotel Arbëria sot Ministria e Drejtësisë. Isha me shërbim dhe pas punës bashkë me kolegët pinim nga një kafe tek bari i hotelit, i cili në darkë mbushej plot, shpesh ndodheshin intelektualët më në zë të Tiranës, aty pinte kafe me shokët e tij edhe shkrimtari Petro Marko i cili banonte fare pranë. Pas diskutimeve për punët e ditës një nga shokët tanë M.Zeka i cili fjetjen e kishte te hotel Peza na thotë që në dhomë më kanë prurë një ish të burgosur e që rrin ditë natë në krevat. Kishte vetëm shpirtin dhe disa çanta të vjetra me libra. Kurioziteti më shtyu dhe të nesermen u bëj një vizitë tek dhoma në katin e dytë të hotel Pezës. I pagjohuri rrinte strukur në batanije ashtu i mbledhur si një presje gjigande. Sytë e tij kafe e errët sikur shkëlqenin, sy të pafajshëm të gëzuar që kishin fituar lirinë pas 37 vjet humbje lirie.

Ditët e para lexoja hezitimin për të biseduar por në vijim sikur filluam të miqësoheshim. Qysh në momentin e parë kur u futa në dhomë më bënë përshtypje disa çanta të vjetra e të mbushura plot me libra sikur të mbartnin thesarin e kursuer disa dekadëshe. Me frigën se mos na prishte punë ne hezitonte për të dalë në kafe e kjo u kapërcye me kalimin e kohës. Vuajtjet dhe të ftohti i burgut e mbanin të mbërthyer në krevat por Sytkiu nuk kishte as të afërm as të njohur në Tiranën a asaj kohe. Kultura e gjërë, dashmirësia, sensi prej intelektualit në bisedë të impononin respekt. Nuk jepte shpjegime nëse nuk e pyesje sidomos për vuajtjet e burgut dhe internimeve që kish hequr, Kultura e gjërë në fusha të ndryshme të jetës gjatë bisedës, dëgjimi me vëmendje, forca argumentuese e shoqëruar me një buzëqeshje karakteristike të impononin jo vetëm admirim por edhe përgatitje dhe kujdes në atë çfarë bisedoje me të. Këto ishin gjuhë dhe para me Sytki Hoxhën, për të cilin duket se pranvera nuk po e ngrohte si ne të tjerëve. Më vonë mbështetur atij "dimri" të burgut shumë vjeçar do të shkruante: "Kur të vdes, dua të më vendosni mbi varr një mangall me prush"

Po çfarë jete pati Sytki Hoxha. Lindi në Gjakovë më 15 dhjetor të vitit 1927 në një familje të madhe e patriotike. Nga kjo familje doli Mehmet Hoxha djali i xhaxhait një intelektual dhe kuadër i lartë në institucionet shtetërore dhe partiake të Jugosllavisë së atëhershme. Mehmetin shpesh në biseda e përmendte Sytkiu dhe mburrej me të. Nga fisi jo i afërt ishte edhe Fadil Hoxha që padyshim të gjithë studiuesit dhe historianët bien dakort se Fadili gjatë gjithë periudhës së Jugosllavisë Titistë qe personaliteti më i spikatur, më i aftë, më orator e icili më diplomacinë dhe aftësitë e veçanta kishte fituar edhe besimin e udhëheqsit Tito. E falë këtyre aftësive të veçanta Fadil Hoxha do të ishte mbrojtësi më me vlerë i gjuhës shqipe, i përpjekjeve të pashoqe për arsimimin e Kosovareve, deri në hapjen e Universitetit të Prishtinës, të dhënjes së autonomisë si krahinë autonome etj.

Sytkiu u rrit së bashku me katër vëllezër dhe tri motra. Mësimet bazë i mori në vendlindje dhe në moshën 16 vjeçare u bashkohet forcave partizane pranë shtabit të përgjithshëm të forcave rajonale në Gri të Tropojës. Nga fundi i vitit 1943 mori pjesë në Konferencën e Bujanit (31 dhjetor 1943 deri më 2 janar 1944) duke mos pasur ndonjë ndikim në të por siç pohonte ai, ndoshta mbiemri e rrethi familjar e shtynë.

Mbas mbarimit të luftës mbeti në radhët e ushtrisë dhe gradohet toger. Shpirti i tij i lirë nuk gjente qetësi dhe largohet nga ushtria dhe punon si sportelist në një hotel në Prishtinë. Jashtë dëshirës së tij e inkuadrojnë në organet e policisë dhe kështu i detyruar shërben në Mitrovicë, Kaçanik, Vuçiternë, Kamenicë dhe Prizeren. Dëshira dhe vullneti për dije bëjnë që pa shkëputje nga puna mbaron gjimnazin. Por Sytkiu kishte besuar në propagandën komuniste gjatë luftës dhe kishte shpresë se prob-



lemet e shqiptarëve do të merrnin zgjidhje pas saj. Gjatë ushtrimit të detyrës së tij në polici ai vëren shumë gjëra si arrestime pa kriter, përndjekje brutale, marrje e prodhimeve bujqësore e blegtorale fshatarve me detyrim, punë vullnetare me forcë e më e keqja vrasje të shumta që kryheshin nga regjimi komunist jugosllav.

Kështu shpirtit i tij i lirë, ndjenjat e thella patriotike bënin që mendimet nuk mund tja shprehte njeriu. Për ti shpëtuar këtij realiteti që çdo ditë e më shumë vështirësohej vendosi të arratiset në Shqipëri, kështu në shkurt të vitit 1949 kalon kufirin dhe futet në Republikën e Shqipërisë dhe kërkon strehim politik. Më vonë shoku i tij i burgut Nazmi Berisha do shkruante: "Për pikëpamjet e tij politike, për të ishte njësoj si të gjendej në Shqipëri, si të gjendej në Hungari, Çekosllavaki. Me këtë dua të bëj të qartë se Sytkiu në Shqipëri nuk kishte dalë as si nacionalist dhe as si pseudonacionalist, por si një vend pjestar të vendeve të "demokracisë popullore". Pikërisht edhe në shtetin amë Shqipëri do të zhgënjehej pasi gjeti ato metoda antipopullora që kishte lënë në Jugosllavi. Kështu shpejt e kuptoi se vendet e demokracisë popullore ishin njësoj, burgosjet, vrasjet, internimet ishin kthyer në modë. Zelli dhe dëshira për dije bëri që të vazhdojë fakultetin për gjuhë-letërsi, shkruante në shtypin e kohës, punoi njëfar kohe si redaktor në gazetën e emigracionit "Za slobodu" si dhe komente tek radio Tirana.

Nuk i kishte shkuar ndër mend që vala e internimit do ta rrëmbente edhe të riun Kosovar i cili thurte ëndrra për jetën, aq më shumë që mori edhe arsimin e dëshiruar. Kështu shpejt përfundoi në kampet e internimit në Llakatund të Vlorës, në Seman të Fierit, Çermë të Lushnjës, e më vonë edhe në Berat. Nga vuajtjet dhe zhgënjimi që pësoi tani mendoi të kthehej nga kish ardhur por marrëveshja mes shteteve kishte bërë që Sytki Hoxha nuk mund të paisej me dokumentacionin e duhur për t'u kthyer në Kosovë.

Në rrethanat e krijuara kur ndodhej në kampin e Llakatundit tenton të kalojë kufirin për tu kthyer në Kosovë por kapet dhe arrestohet. Tentativën e parë të arratisjes nga Shqipëria e kish bërë për në Greqi më 1957, e si pasojë e një denoncimi nga një emigrant Kosovar, e kapën, e torturuan në degën e Brendëshme në Korçë e më pas në Tiranë. Ku dhe

i kërkuan bashkëpunim, e dërguan në kampin e Llakatundit. Kalvari i vuajtjeve me thyerje krahu dhe të kokës, me elektroshok për ta shkatërruar fare, dhe kur tregonte Sytkiu ato netë dimri sytë e mbusheshin me lotë.

U dënua me 15 vjet heqje lirie me akuzën "tradhëti ndaj atdheut dhe për agitacion e propagandë". Me mbarimin e dënimit nuk pranoi të dalë që andej veçse me kusht që ta përcillnin për në vendlindje. Pasi e nxjerrin me forcë dhe nën shoqërimin e dy policëve e çojnë në kampin e Semanit ku gjendeshin rreth 240 emigrantë të kombësive të ndryshme, e që pritnin të ktheheshin. Aty bëhej tre herë apeli gjatë ditës, ruhej me policë dhe qen. Në një nga ditët meqenësë nuk po e riatdhesonin gjen mundësinë dhe ikën bashkë me një shokun e tij Muharrem Bërdynën me të cilin gjatë udhëtimit natën humbin njëri tjetrin. Pas katërmëdhjetë ditëve udhëtim e kapin në fshatin Zogaj të Shkodrës, ashtu të rraskapitur nga rruga ditë e natë dhe i pa ushqyer, e kapin forcat e kufirit Shqiptar. E futin përsëri në burg kështu nga viti 1967 deri në 1987 do të qëndronte në burg me dënime e ridënime. Këto periudha të errëta Sytki Hoxha I quante "Universiteti" dhe shokët e bashkëvuajtur kështu i quante "shokët e Universitetit". Kështu me dënime e ridënime plotëson plot tridhjet vjet në burgjet Shqiptare.

Pikërisht në Hotel Peza Sytkiu më tregoi edhe një letër që i kishte dërguar ish Presidentit Alia shkruar me një kaligrafi të bukur e qartësi për vuajtjet dhe dënimet e njëpasnjëshme, me akuzat të pabaza që i kishin humbur rininë e tij, ëndrrat për jetën. Ramizin e quante kopje të Enverit që përpëlitej para se të vdiste, që nuk dha shpirt por do te jepte dorëheqje. Por vuajtjet nuk e kishin mposhtur shpirtin e lirë të Sytki Hoxhës. Jam përpjekur të jem i lirë, të mos pajtohem me gënjeshtërën, dhunën dhe skllavërinë. Në këtë drejtim thoshte e admiroj macen që s'pranon pranga. Ajo mbi të gjitha preferon të jetë e lirë.

Vitet e gjata të "Universitetit" i kishin mundësuar qëndrimin dhe njohjen me mjaft intelektualë e personalitete të kulturës, artit, gjuhësisë, figura të cilat do të mbante lidhje dhe kujtime deri sa qe gjallë, si Pjetër Arbnori, Daut Gumeni, Nazmi Hoxha, Sherif Merdani, Zenel Peposhi etj. Mbas qëndrimit në hotel Peza Sytkiu u transferua në një banesë më qëra në rrugën e Kavajës, kjo u mundësua pas lidhjes me motrën dhe mbesat që kishte në Gjerman.

Aty u rehatua si të thuash në pritje të largimit nga Shqipëria. Shpeshi i bëja vizita në shtëpi dhe si gjithmonë ashtu i qeshur, i gëzuar dukej se kishte gjithë të mirat e botës. Fliste gjithmonë fjalë të mira, të ëmbla me të gjithë, bënte humor, nuk prekej dhe me natyrën e tij i jepte çdo bashkëbiseduesi pozitivitet dhe këndshmëri. Vizitat tek Sytkiu gjithmonë zgjasnin më shumë se ishin planifikuar, pra prishej protokollit. Kur ngrihej për të qerasur me shakaill thoja lëre o i zoti shtëpisë se bisedat me ty të zgjasin jetën, ushqimet shpejt treten, sikur ke dalë nga burgu t'na japësh kurajo gje energji positive ne që kemi qënë jasht. Ashtu me buzën në gaz si gjithmonë me pak ndryshim kemi qënë thoshte ai.

Përgjithësisht Sytkiu nuk fliste pa e pyetur, pasi vetë nuk kishte dëshirë të tregonte. Me kulturën e gjërë që kishte kur flistë për burgje, torturë, internim, izolim, grevë urie, hetim dhe torturë, vdekje, sëmundje por më dëshirë donte të flistë për shokët në burgje e internime. Ai i donte dhe çmonte njerzit, nuk kishte paragjykime se nga vinte njeriu dhe çfarë ngjyre kishte, moshë dhe besimi nuk kishin rëndësi për të, por rëndësi u kushtonte vlerave, kontributit në shoqëri, aktivitetit jetësor.

Gjatë bisedave jo të rralla me Sytki Hoxhën më bënte përshtypje fakti që megjithë vuajtjet e panumërta që kish kaluar në internime dhe burgje

(Vijon në faqen 11)

NDERIMI

NJË SHKOLLË ME EMRIN E VETERANIT TË ARSIMIT SKËNDER KUTA

Nga **MEVLUD BUCI**

Që prej një viti (3.02.2023) shkolla 9-vjeçare Bllaçe në Njësinë Administrative Fushë Çidhën mban emrin e mësuesit veteran Skënder Kuta. Këshilli Bashkiak Diber me këtë akt (Vendimi nr. 38, datë 3.02.2023) ka kryer një akt të lartë morali dhe respekti ndaj një figure të ndritur, veteranit të arsimit Skënder Kuta, i cili dha një ndihmesë në arsim, që u vlerësua në kohë dhe vlerësohet edhe sot nga kujtesa e ish-nxënësve të tij dhe e njësive të pushtetit vendor, nga një opinion më i gjerë.

Skënder Kuta u lind në Bllaçe, një fshat me tradita patriotike.

Shkollën fillore e mbaroi në vendlindje nga viti 1948-1952. Nga viti 1953 u regjistrua në shkollën e Kastriotit në Fushë –Ali, të cilën e përfundoi me rezultate të larta më 1956. Më 1956-1960 përfundoi Shkollën Pedagogjike në Peshkopi, me rezultate të larta.

Më 1980 Skënder Kuta emërohet mësues në shkollën 7-vjeçare të Fushë –Alisë.


Më 1964-65, punon mësues në Zogjaj, pastaj punon në Vrenj etj. Më 1970 ai fillon studimet për gjuhë dhe letërsi në Universitetin e Tiranës, studime që i mbaron me rezultate të larta. Punon sërish në Bllaçe dhe nga viti 1977 si mësues në shkollën e mesme të Fushë-Alisë.

Nga viti 1993 emërohet drejtor shkollë në Bllaçe.

Një karrierë e shkëlqyer dhe një punë përkushtuese e shoqëron figurën e këtij veterani të arsimit. Edhe tani në moshën 85 vjeçare, Skënderi kujton ato vite të vështira me mungesa të mëdha por me pasion dhe dashuri të jashtëzakonshme për dijen, ku arsimit shikohej si prioritet i ecjes përpara.

Skënder Kuta ishte mësuesi dhe pedagogu që nuk e pati të lehtë, por kurrë nuk i tha punës jo dhe kurrë nuk përtoi të shërbente nga një shkollë në tjetrën, atje ku kishte më shumë nevojë për mendjen dhe përkushtimin e tij si mësues dhe edukator i brezave.

Edhe sot në këtë moshë, ai është i kthjellët, ak-



tiv dhe kujton me respekt kolegët, ish-nxënësit e tij dhe ndihet i gëzuar se mjaft prej tyre janë bërë dikush në jetë, madje kanë kapërcyer pritshmëritë e tij kohore. Është i gëzuar se injektoi te këta nxënës besim, kurajo, mirësi, dashuri për dijen,



kulturë, atdhedashuri dhe mirësi, përkushtim për punën, të gjitha këto veti të një mësuesi të talentuar që ka ditur t'i transmetojë e përçojë në mendjet e vogëlushëve të dikurshëm.

Janë të rralla rastet kur figura të tilla përjetojnë që në gjallje një nderim të tillë dhe ky nderim nuk është diçka rastësose. Ishte kërkesa e dhjetëra – qindra ish-nxënësve të Skënder Kutës, e cila iu adresua organeve të pushtetit lokal që kjo shkollë të mbante emrin e tij dhe kjo kërkesë vjen në unison edhe me mendimin e mjaft njerëzve të tjerë, prindër e me gjerë, gjë që shkojnë natyrshëm tek një vlerësim i merituar për një nga veteranët e shquar të arsimit në Diber për një figurë me vlera, që rrezatoi dje, sot e gjithnjë në fushën e arsimit dhe të edukimit e të dashurisë për dijen.

17 VJET NGA IKJA E SYTKI HOXHËS

(Vijon nga faqja 10)

ai ishte brilant përse u përket kthjellësisë së mendimeve, forca e tij argumentuese dhe shpeshherë këmbëngulja për çështje kulture, dijeve shkencore dhe politike.

Ai ishte nga ata që njihte mirë veten dhe bashkëbiseduesin por edhe nuk hapte rrugë, pra ishte stoik në qëndrimet e veta. Librat e tij, më mirë të them biblioteka e tij e pasur, që çuditërisht ishte siguruar gjatë kohës të burgur ishte pasuruar edhe me metoda dhe fjalor të gjuhës gjermane dhe francize.

Metodën më të mirë të mësimit gjuhës francize ma dhuroj me shumë kënaqësi. Këtë metodë e kam shkruar vetë me dorën time më tha, ndoshta është më e mira që mund të gjendet. Asokohe mësoja gjuhën italiane tek i madhi professor Dhimitër Canco, një polyglot dhe erudite nga të rrallët që kishte vendi. E pas kësaj të duhet mësimi i frëngjishtes që pot ë lë kujtim më tha Sytkiu. Metoda e shkruar me një kaligrafi shumë të bukur, e qartë, me rezervë blu dhe të kuqe, më duket një thesar i çmuar, kujtim nga i paharruari miku im Sytki Hoxha.

Pas përpjekjeve të shumta ju mundësua vajta në Gjermani aty ku kishte të afërm e më vonë u vendos në Norvegjinë e largët, pikërisht në Orje.

Fati e ndihmoi Sytkin dhe më 1994 takohet në Tiranë me zonjën Mimoza Përlekën të cilën ja prezanton miku i tij Daut Gumeni. Ato u martuan dhe kaluan një jetë të qetë e të lumtur në Norvegji, e shpesh kthehej për të takuar miqtë e tij në Tiranë.

Gjatë qëndrimit në Norvegji shkruan publicistikë, shkrime letrare, ndjek me vëmendje zhvillimet politike të Tiranës por pa ndërprerë lidhjet e letërkëmbimet me miqtë. Kështu gjejmë letra shkruar Pjetër Arbnorit, Uran Kalakulën, Dom Simon Jubanin, Myrteza Bajraktarin, motrën e tij Behije.

Në një letër që i shkruante Dom Simonit për jetën në Norvegji thotë: "Njerëzit norvegjezë, ndonëse me ngrohtësi të paktë diellore, zemrat për njerëzit e vuajtur i kanë jashtëzakonisht të ngrohta, janë kurdoherë të gatshëm të të ndihmojnë për çdo gjë. Norvegjezët, në mes të cilëve gjendem, qenkan gjerëz të vërtetë, njerëz të Perendisë, njerëz të çiltër, njerëz të thjeshtë, njerëz pa qibër, pa fodullëk, njerëz që s'dinë të të gënjejnë, njerëz që nuk e vënë në dyshim fjalën që u thua njerëz që nuk dinë që të vjedhin, njerëz që e ndjejnë vehten të sigurt.

Këtu për nga sjellja është vështirë të dallosh se cili është punëtor dhe cili ministër. Admirimi im për norvegjezët dhe Norvegjinë e çdo gjë norveg-

jeze është aq i madh, sa edhe i vdekur nuk dua të ndahem prej tyre. Do ta lë me shkrim që të më varrosin në Norvegji"

Dhe kështu ndodhi në të vërtetë. Pas një sëmundje ndroji jetë më 5 qershor të vitit 2007. Kështu u nda nga jeta një nga personalitetet më të mëdhej të kombit, njeri i veçantë, i fortë në shpirt, njeri i cili dinte të jepte vetëm gëzim, që dhuroi jetën e tij për lirinë dhe drejtësinë. Daut Gumeni miku i tij, bashkëvuajtësi i tij prej 24 vjetësh thuri vargje:

NJË DORË PRUSH

U shove miku im, aty në veriun e largët, dhe na le prapa, të qeshurën e bardhë.

Na le mospërfilljen për pushtetin e paligjshëm,

Na le guximin e rrallë për të përballuar hidhërimet,

Na le fuqinë për të ngjitur të përprjetat duke duruar plagët.....

Lamtumirë, miku im I vuajtjeve të rënda!

Lamtumirë ti mërgimtar i përhershëm që ike i vetmuar për ti mbajtur dhimbjet për vete e për ti ndarë gjithmonë nga një dorë prush dashurie mbi varre mërgimtarësh mbuluar me borë vetmie!

KOMENT

NJË ÇEREK SHEKULLI NGA ÇLIRIMI I KOSOVËS

Nga Bashkim Hisari

Pranvera e vitit 1999, për shqiptarët e Kosovës ishte një nga periudhat më tragjike në historinë e gjatë të shtypjes, vuajtjes dhe pritjes së lirisë dhe pavarësisë. Me fillimin e bombardimeve të NATO-s, njëzetepesë vjet më parë, fshatrat në zonën e Prizrenit, si Landovica, Jeshkova, Lezi, Pirana, Krusha e Madhe, Krusha e Vogël, Celina, Bellacerka, sikur edhe shumë fshatra të tjerë gjithëandë Kosovës, u rrafshuan pothuaj tërësisht me tokën.

Forcat ushtarake policore dhe paramilitare serbe shkatërruan gjithçka: jetën e njerëzve, shtëpitë dhe pronat. Banorët me traktorë e rimorkio të mbuluar me najllon apo çadra, shumë prej tyre edhe në këmbë, të shqetësuar dhe frikësuar tej mase, morën arratinë për të shpëtuar nga ndjekjet e kriminelëve. Për shumicën, vetëm vdekja ishte më e keqe se të qenit refugjat. Nuk e dinin se cili do jetë fati i tyre, nëse do t'i jepnin fund jetës nga plumbat dhe predhat serbe, në ujërat e Drinit të Bardhë apo do të ekzekutohen diku rrugës për në Kukës. Në atë udhëtim të gjatë, frika ishte bërë mënyrë e jetesës së tyre. Pas vete kishin lënë vuajtjet më të rënda, vrasje të planifikuara të njerëzve të pafajshëm, rrëmbimet dhe dhunimet, plaçkitjet, shtëpitë të shkatërruara deri në themel dhe fushat e tyre pjellore. Në rrethana të ngjashme u gjendën shumica e shqipëtarëve.

Por, njëzetepesë vjet më parë, pas 78 ditëve të bombardimeve, më 10 qershor, NATO ndërpreu fushatën e goditjeve të caqeve ushtarake serbe në Kosovë.

Fushata e sulmeve u ndërmor për të ndalur aktet e veprimeve të dhunës së egër dhe shfarosjen e plotë të popullit shqiptar nga forcat e regjimit autoritar të Slllobodan Millosheviqit. Me zbarkimin e trupave të para të NATO-s, më 12 qershor, Serbia kapituloi dhe u hapë rruga e lirisë për Kosovën. Shqiptarët shpëtuan, paqja u vendos përmes nënshkrimit të Marrëveshjes Ushtarake-Teknike në



Kumanovë. Marrëveshja përfshinte tërheqjen e forcave serbe nga Kosova, vendosjen e një force të sigurisë të udhëhequr nga NATO dhe kthimin e shqiptarëve në shtëpitë e tyre.

Gjatë konfliktit të armatosur dhe bombardimeve të NATO-s nga Kosova u dëbuan mëse 800 mijë njerëz, u vranë dhe u masakruan rreth 14 mijë civilë shqiptarë dhe pjestarë të UÇK-së. U përdhunuan rreth 20 mijë femëra shqiptare. Të zhdukur me dhunë janë regjistruar njëmijë e 600 shqiptarë. Shumë trupa të viktimave ende gjenden në varret masive të fshehura në Serbi.

Në Aktakuzën e Prokurorisë së Tribunalit Penal Ndërkombëtar për ish-Jugosllavi kundër Slllobodan Millosheviqit dhe zyrtarëve të tjerë politikë dhe ushtarako-policorë për krimet e kryera kundër njerëzimit dhe shkeljes së ligjeve ose zakoneve të luftës në Kosovë (Lënda: Nr. IT-05-87-PT) pos tjerash thuhet se "kanë ekzistuar ndërmarrje të përbashkëta kriminale, që kishin për qëllim ndryshimin e përbërjes etnike në Kosovë" Prandaj, janë akuzuar për gjenocid, vrasje, përndjekje politike dhe burgosje të paligjshme, dëbime dhe zhvendosje me forcë, shfarosje, torture, shkaktim të vuajtjes së madhe të qëllimshme, trajtim mizor, plaçkitje të pronës publike ose private etj. Për të gjitha këto krime ekzistojnë dokumentet e shkruara, letrat, raportet e luftës, urdhërat, fjalimet, artikujt e

gazetave, dëshmitë e dëshmitarëve okularë, fotografi, video incizime, prova fizike-varrezat masive dhe dëshmi tjera.

Por, kriminelët dhe drejtuesit politik të Serbisë deklarojnë se bombardimet kanë qenë politike e jo ushtarake duke theksuar: "Ne mbrojtëm atdheun, luftuam kundër terroristëve dhe përkrahësve të tyre, ruajtëm kufijtë shtetërorë dhe duruam gjithçka në mënyrë stoike dhe heroike".

Pas bombardimeve të NATO-s, Këshilli i Sigurimit i OKB-së miratoi rezolutën 1244 e cila territorin e Kosovës e vendosi nën mandatin e OKB-së.

Më 17 shkurt të vitit 2008, Kuvendi i Republikës së Kosovës në Prishtinë shpalli Pavrësinë, kurse më 9 prill 2008 u miratua edhe Kushtetuta e Republikës së Kosovës,

Gjatë njëzetepesë viteve në liri, Kosova ka ecur përpara. U shndërrua në një vend të lirë, demokratik dhe paqedashës, shtet i mirëqenies ekonomike dhe i prosperitetit social, atdhe i të gjithë qytetarëve ku garantohej të drejtat dhe liritë e barabarta për secilin qytetar.

Megjithëate, Kosova ka ende sfida të mëdha me shtetin jodemokratik serb që është zhytur në autoritarizëm, meqë me dhunën e të privilegjuarëve ka pushtuar të gjitha institucionet shtetërore, gjyqësorin, policinë, ushtrinë, financat, mediat dhe ka nënshtruar miliona njerëz. Me drejtimin ideologjik të politikës së tillë në Serbi po forcohet ekstremizmi i djathtë me elemente neofashiste. Piromanët e luftës dhe urretjes nga Beogradi edhe kur bubullon në Beograd, fajësojnë shqiptarët. Trumpejojnë në të katër anët se "kurrë nuk do të njohin pavarësinë e Kosovës" e cila është njohur nga ana e rreth 110 shteteve të botës, duke përfshirë fuqit perendimore.

Theksojnë se Kosova "është pjesë e patjetërsueshme e Serbisë" dhe me çdo kusht do të ruajnë integritetin territorial dhe sovranitetin e shtetit. Vazhdimisht angazhohen në fushata lobuese kundër Kosovës që është shkelje e rëndë e marrëveshjeve për normalizimin e marrëdhënieve. Mendojnë vlerat e LANÇ dhe luftën e UÇK-së për liri, vetëvendosje dhe pavarësi.

Përmes retorikës së përditshme të zyrtarëve politik në media, posterëve, sloganeve, billbordeve, ekraneve me

ndriçim, fjalimeve të ndryshme të pakuptimta kuazi-patriotike për serbizëm duke sulmuar shqiptarët, nuk është asgjë tjetër përpos shtyrje e të vërtetës në harresë nga ana e njerëzve pa kurrizë, fytyrë e ndershmëri. Elita politike që ka qeverisur Serbinë, nuk ka barrë më të madhe se ballafaqimi me të kaluarën, me krimet më monstruoze që janë kryer në Kosovë. Është shqetësuese se në homogjenizimin e serbëve edhe Kisha Ortodokse Serbe është bërë shtylla e kësaj politike, duke u eksponuar edhe me fjalë provokuese dhe ofenduese drejtuar shqiptarëve.

Kategoritë e pushtetarëve serbë që kanë pasur mentor kriminelin Slllobodan Millosheviq, nuk po ndalen me provokime për destabilizim të Kosovës, por edhe gjithë Ballkanin. Më 8 qershor, 2024 në Beograd, organizuan të ashtuquajturin "Kuvend gjithëserb" ku miratuan një deklaratë

Ky manifestim gjithëserb ishte një tubim politik folklorik, demonstrim drejtuar shqetësimit për serbizmin, gjoja bashkëkombasit e tyre në Kosovë "jetojnë në kushte të patolerueshme të krijuara prej autoriteteve të Prishtinës". Ishte ky një kundërshtim ndaj Rezolutës që u miratua së fundi në Asamblenë e Përgjithshme të KB për gjenocidin në Srebrenicë ku në vitin 1995 serbët vranë më shumë se 8 mijë burra dhe djemë boshnjakë. Ishte edhe një promovim i Aleksandar Vuçiqit si "president i të gjithë serbëve" Thirrja për unitet të serbëve në rajon dhe mbrojtja e interesave serbe, nën moton "Një popull, një kuvend Serbia dhe Srpska" ishte e ngjashme me sloganet famëkeqë të regjimit nazist: "Një popull, një mbretëri, një udhëheqës" ("Ein Volk, ein Reich, ein Führer"). Të gjitha këto sjellin pasojë që edhe takimet më të rastësishme të qytetarëve në sheshin Nëna Terezë të Prishtinës, në shetitoret dhe kafiterit buzë Lumbardhit në Prizren apo te pazari i vjetër në Çarshinë e madhe të Gjakovës dhe gjithëandë Kosovës, të shëndërrohet në top temë dhe polemikë të vrullshme politike për çështjet aktuale të marrëdhënieve midis Kosovës dhe Serbisë.

Qytetarët kërkojnë që dialogu mes Kosovës e Serbisë të përfundojë sa më shpejtë me njohje reciproke. Janë për paqe, stabilitet dhe bashkëpunim në rajon, për një jetë më të mirë për të gjithë, por shprehin brengosje për kërcnimet që vijnë nga Serbia dhe për koncentrimin e forcave ushtarako-policore në kufi me Kosovën. Megjithëatë janë optimist pasi në Kosovë janë paqeruajtësit e NATO-s dhe në Kosovë, është "Bonstili" baza më e madhe ushtarake amerikane në Ballkan,

Nga organet shtetërore kërkojnë të artikulojnë më mirë qëndrimet e veta zyrtare në koordinim me faktorin ndërkombëtar, të punohet së bashku për ndërtimin e rritjes ekonomike gjithëpërfshirëse, në forcimin e institucioneve demokratike, shtetit të së drejtës, dhe në avancimin e reformave të nevojshme për të arritur përfundimisht objektivin e Kosovës, integrimin në BE dhe në NATO.



DITELINDJA E 89-TË

XHEMAL MEÇI, HISTORIANI I MADH I QYTETIT TË VOGËL

• **HALIT FURRIKU, intelektual, ish-kryetar i bashkisë Pukë dhe kryetar i Shoqatës Kulturore-Artistike "Puka" shprehet** "… Ai është jo vetëm punëtor, por edhe një arkiv i gjallë i traditës, kulturës dhe i historisë së Pukës dhe më gjërë"

Nga Idriz Ahmetaj


Studiues

E vështirë dhe fisnike kjo detyra e historianit. Kërkon përveç skrupoluzitetit, edhe kthjelltësinë e mendimit, edhe njeriun këmbëngulës e sistematik, edhe njohuritë e gjëra të shkencëtarit, edhe vendosmërinë për t'iu shkuar gjërave deri në fund. Të gjitha këto cilësi janë të mirëndodhura tek zoti Meçi. Ai punonte gjithë ditën duke i mbledhur shënime nga goja e njerëzve dhe në mbrëmje deri natën vonë dëgjohej rrapëllima e makinës së shkrimit "Olivetti" që ia kishte dhënë një koleg, të cilat i rregullonte dhe i sistemonte për t'i përdorur më vonë.

Shprehet Ndoci për Xhemalin: "Ishte djalë i ri, bile shumë i ri dhe i imët në fytyrë e shtat kur udhëton-te rrugëve malore të rrethit të Pukës nga një fshat në tjetrin si të gjithë te paktët mësues për të mundësuar mësimin e a,b,c, nxënësve të malësisë. Ndryshe nga të gjithë, Xhemal Meçi mbante në një anë të çantës së ditarit të mësimit edhe një bllok shënimesh për të "incizuar" të gjitha ato mrekulli të zakoneve, traditave, të veshjes, të të folurit, këngët popullore, një jetë e tërë malësore që nuk mund të jepet rasti të përsëriten kurrë më".

Dhe Xhemali kujton me nostalgji kur kalonte në Qllumin e Merturit për të parë "Shkrolat e Turkut": "Të dëshpëruar se nuk arritëm t'i përcaktonim siç shpresonim dhe të rrahur nga një diell i fortë, i mbështetur nga shkëmbi, u kthyem tek shtegu nga erdhëm.

Më propozuan që të ndiqnim majën e shkëmbit, sepse rruga për në lballë, ku doja të kthehesha, ishte shumë më e shkurtër. Mirëpo, pa kaluar as 50 m u befasuam nga zigzagët e majës së shkëmbit, që në atë pikë ishte aq i mprehtë, sa vendasit për të kaluar e kishin thyer majën e shkëmbit me gurë duke hapur një si rrugë të ngushtë. Mbi atë të rrafshuar gropa-gropa, kishin futur ndonjë gur të vogël për ta mbushur që të ishte më i sheshtë për t'u mbështetur këmba. Në të dy anët shkëmbi binte thikë. Tani më dukej vetja si një pëhlivan cirku që donte të hipte mbi një tel që kalonte nëpër dhëmbët e vdekjes. Ngurrova të kaloja, po më



nxisnin të mos kisha frikë, se aty ata kalonin shumë herë.

Pushkatarin kaloi fare lehtë, ndërsa mua më zgjati qytën e pushkës që të kapesha. Po të më humbiste sadopak ekuilibri, do të bija në greminë, duke marrë edhe pushkën me vete ose duke u shkëputur pa pasur mundësi të kapesha pas saj.

Shoqëruesit po humbnin durimin dhe po më shikonin duke më marrë për frikacak. Kjo po më bezdiste, sa më në fund i thashë pushkatarit që të kalonte vetë dhe të më hapte vend për të kaluar shpejt me kërcim duke ruajtur ekuilibrin. Më dukej se nga frika isha bërë i lehtë si pendë, sa mend futuroja.

E ku pa! Në atë lartësi ku poshtë meje shtrihesh humnera prej qindra metrash. Fantastike. Dhe duke u kthyer në realitet mezi ruaja vetëdijen, aq kalim i vështirë ishte. Pak metra dhe maja arrinte lartësinë më të madhe: mbi 1400 m. Këtu vendi ishte më i sheshtë dhe i hapur. U desh mbi një orë rrugë që ta merrja veten. M'u kujtuan fjalët e një plaku që takuam në Pjeprishtë, që u tha shoqëruesve: "Kini kujdes, se mos ju rrëzohet ky shoku, se nuk është mësuar!". Në vazhdim zbritëm duke shijuar një horizont aq të hapur me ajër të freskët e të lehtë, sa mushkëritë e dëshironin dhe pasi mbusheshin me të nuk ngopeshin, ramë të "Shpella e Robve".

E shoh tek "bredh" sa në një fshat në tjetrin, sa te një vendbanim historik, te një kala e mbuluar nga harresa, sa te një kasolle e sa te një kullë edhe pse mbi shpatulla mban peshën e kaq viteve, por trupi nuk e tradhton. Ai ka mbetur djaloshi i viteve të rinisë me shtatin plep të drejtë, me hijeshinë e burrit të fisëm që gjithë jetën pat aq forcë që t'i japë historisë shqiptare, truallit të vet, Pukës që e do aq fort tërë

kapacitetin e dijen e tij prej intelektual, prej patrioti, prej njeriut e shqiptarit të vërtetë.

linxhinieri i nderuar Kol Dedaj, botues i disa librave në profesionin e tij vlerëson se: "Vepra shkencore e Xhemal Meçit është një diamant i stolisur në memorien tonë, është një pishtar i ndezur që brezat që vijnë ta trashëgojnë dhe të orientohen prej saj edhe sot qytetarë, lexues e studiues, profesorë e akademikë e çojnë përpara".

Në punën e tij shkencore dhe jo vetëm Xhemal Meçi është shterrues. Përgjithësisht, do të thosha pa superlativa, së gjithë asaj që ai ka lënë, nuk ke se ku t'i shtosh a ti heqësh qoftë edhe vetëm një presje.

Halit Furriku, intelektual, ish-kryetar i bashkisë Pukë dhe kryetar i Shoqatës Kulturore-Artistike "Puka" shprehet "…Ai është jo vetëm punëtor, por edhe një arkiv i gjallë i traditës, kulturës dhe i historisë së Pukës dhe më gjërë".

DISA NGA VEPRAT E BOTUARA ME AUTOR XHEMAL MEÇIN

Zakonisht në përvjetorë bëhet një bilanc dhe po përipiqem t'ua jap një bibliografi të z. Xhemal Meçi punimet e tij të botuara dhe të pabotuara në mënyrë kronologjike:

- "Kanuni i Lekë Dukagjinit (vari-anti i Pukës)", 1996, ribotim më 2018;
- "Kanuni i Lekë Dukagjinit (varianti i Mirditës)", 2002;
- "Puka që në lashtësi", 2003;
- "Kabashi", 2008;
- "Poeti i malësisë", 2015;
- "Poeti i Kabashit", 2016;
- "Komani-ana e Drinit", 2019. Dorëshkrimet:
- "Karma, Vjerdha, Dushi, Qerreti, Kçira";
- "Pasuria gjuhësore e Kanunit të Lekë Dukagjinit";
- "Ndihma e Pukës për imzot Terenc Toçin";
- "Injac Zamputi";
- "Lumëziu-qyter i lashtë";
- "Kabashi (Laçajt)";
- "Frang Bardhi dhe Puka";
- "Hyra";
- "Fshati i bashkuar Qerret-Pukë";
- "Lekë Dukagjini në burime historike";
- "Kabashi etnografik";
- "Si qëndron e vërteta e origjinës së Dhimitër e Nikollë Berishës";
- "Malësia e Gjakovës";
- "Eqrem Çabej";

• Jeta është ajo që na është dhënë..Por është edhe ajo që e ndërtojmë vetë. Bile ajo që ndërtojmë vetë ka më shumë rëndësi, më shumë vlerë. Që në titullin e këtij shkrimi nuk munda të mos përfrazoja studiuesin, poetin dhe intelektualin, të ndjerin Ndoc Selimi që e ka quajtur z. Xhemal Meçi Historiani i madh i qytetit të vogël".

• 89 vjet. Një jetë mjaft e gjatë e përdorur me kujdes e mençuri në shërbim të familjes, komunitetit dhe mbarë shoqërisë shqiptare.

- "Sutë Pjetër Basha";
- "Shënime mbi rrethanat e vdekjes së Pjetër Budit";
- "Këngë popullore historike e legjendare";
- "Një kështjellë në Kryezi"; - "Berisha";
- "Kanuni i Lekë Dukagjinit dhe Aleksandri i Madh".

VLERËSIME PËR XHEMAL MEÇIN NGA INSTITUCIONE QËNDRORE E LOKALE

Kontributi studimor i Xhemal Meçit është vlerësuar nga organizma dhe forume nga më prestigjiozet, me urdhra, medalje e dekorata si:

Medalje "Naim Frashëri" nga Presidiumi i Kuvendit të Shqipërisë, Tiranë, 1972

Titull Nderi "Mirënjohje e qytetit Pukë", Bashkia Pukë, 2000;

Urdhri: "Naim Frashëri i Argjendtë", Presidenti i Republikës, Tiranë, 2000


Urdhri: " Mjeshtër i Madh", Medalje e Artë, Presidenti i Republikës, Tiranë, 2011;

- **"Çmimi i Virtytit"**- Për veprimtari të shquar në shërbim të Paqes, Progresit dhe Mbrojtjes së të Drejtave të Njeriut nga Komiteti i Pajtimit Mbarëkombëtar, Tiranë, 2013.

- **Qytetar Nderi i Bashkisë Pukë"**, 2015

Nuk di nëse munda t'i veçoj si e sa duhet, pasi "universi" i Xhemal Meçit është i madh, sa mund të humbisja në të 89 vjet. Ai është etnologut, kulturologu, publicisti, veprimtari pujan, Xhemal Meçi - "Mjeshtër i Madh", autor i 10 librave me mbi 3.800 fage dhe i mjaft artikujve nga fusha arsimore pedagogjike, historike, folklorike e etnografike.

Një jetë jo e shkurtër, po Xhemali si dikur djalë i ri dhe i imët e mban përsëri çanten me vete. Në të nuk ka më fletoret e ditarit e planeve mësimore, po libra të botuar (e çfarë librash!) disa prej të cilëve ua dhuron shokëve e bashkëpunorëve. Sa do që pasha e viteve I rëndon mbi supe, ai ka mbetur si një plep i drejtë me një kujtesë për t'ia pasur zili dhe me shumë vullnet e dëshirë për punë të mira.





STUDIMI

Studimi i gjuhëtarit të njohur/ U vlerësua nga Kadare, por u injorua nga Akademia e Shkencave

PETRO ZHEJI: “SHQIPJA ËSHTË MËMA E TË GJITHA GJUHËVE”

• **Insistimit të gjuhëtarit të shquar Zheji për të argumentuar lashtësinë e shqipes, akademiku Buda i është përgjigjur me këshillimin: “Kujdes djalë, se të ikën koka”!**

• **Profesor Petro Zheji, pas vendosjes së demokracisë emigroi për shumë vite në Amerikë, SHBA, ku, në sajë të zotërimit të mbi dhjetë gjuhëve të huaja, i thelloi e i zgjeroi edhe më shumë studimet e tij në fushën e Gjuhës Shqipe. Gjatë kohës në SHBA kemi pasë letërkembime të vazhdueshme me të**



Xhemal MEÇI*
Halil RAMA*

Shtatëmbëdhjet vjet më parë (13 shtator 2007) gjuhëtar i shquar Petro Zheji, në promovimin e veprës së tij akademike “SHQIPJA DHE SANSKRITISHTJA”, në Pukë, deklaroi se “shqipja është mëma e të gjitha gjuhëve”.

Këtë të vërtetë e pohon edhe gjuhëtar i njohur Albert V.Nikolla, i cili në një intervistë për gazetën “NACIONAL” (13 janar 2024) ndër të tjera shkruan se “...kur sigurimi i shtetit, dërgoi emisarë tek Çabej për ta pyetur se çfarë mendonte për Petro Zhejin, ai iu përgjigj se: “Të dy, unë dhe Zheji kemi të njëjtin qëllim: të ndriçojmë vjetërsinë e gjuhës shqipe, por rrugët që kemi zgjedhur si metodologji janë të ndryshme”. Gjithsesi kuptohet që Çabej qe shprehur pozitivisht për studimin e thelluar të P.Zhejit.

Në vlerësim të kontributit madhor të të përjavshmes prestigjioze letrare e kulturore “NACIONAL” dhe të Drejtorit të saj Dr.Mujo Buçpapaj, për evidencimin e shqipes si një ndër tri gjuhët më të vjetra indo-europiane që fliten ende, po sjellim në vëmendjen e lexuesit bisedën tonë të para 17 viteve me prof. Petro Zheji. Ndërsa na kishte dhuruar një kopje të daktilografuar të studimit të tij të mahnitshëm “Shqipja dhe Sanskritishtja”, (të cilin e lexuam me interes të veçantë), për herë të parë po mësonim prej tij se gjuha jonë shqipe është e lashtë sa vetë njerëzimi dhe e vetmja me koeficientin më të lartë që motivon vetveten dhe po kësh-tu edhe gjuhët e tjera, çka përbën veçorinë dhe epërsinë e saj në raport me gjuhët e tjera simotra. Por askush nuk i hapte rrugë botimi Studimit të Tij.

Pas kësaj insistuam që professor Zheji t'i kërkonte takim kryetarit të Akademisë së Shkencave, Prof. Aleks Budës dhe t'ia parashtrojë studimin me tezat e tij, në lidhje me gjuhën shqipe? Dhe ai na pohoi se këtë ia kishte sugjeruar edhe shkrimtari ynë i madh ISMAIL KADARE, i cili jo vetëm e kishte lexuar e vlerësuar por edhe ishte entuzhuar nga punimi i tij.

“Në Akademinë e Shkencave kanë dijeni për Studimet e mia, por nuk denjojnë të shprehen, t'i pranojnë as t'i rrëzojnë idetë e mia dhe as Aleks Buda nuk pranon të më presë bile”, - na tha disi i revoltuar.

Profesor Petro i jepte mësim të



gjuhës frënge privatisht vajzës së Aleksit, e cila më vonë e ndërmjetësoi tek i ati dhe ai një ditë e priti në takim.

Sipas Petros ai e priti ftohtë, por e dëgjoi. Nuk ia pranoi konkluzionet e Studimit të Tij dhe as pranoi ta studio-inin atë si Akademi..

-Midis tyre,- siç na tregoi Petro,- ishte zhvilluar një debat bukur i fortë sa i kishte thënë se - “Gjuha Shqipe është një gjuhë shumë e vjetër, e pa zhvilluar dhe e shkruar shumë vonë ndryshe nga gjuhët e tjera të shkruara shumë herët”.

Atëherë, Profesor Petro i kthehet dhe i thotë: “Po pikërisht këtu, tek vjetërsia e saj, shoku Aleks, qëndron rëndësia e gjuhës sonë, sepse ka mundur të ruajë origjinalitetin e saj pa u shue me kohë si shumë gjuhë të tjera të vjetra”. Por insistimit të gjuhëtarit të shquar Zheji, akademiku Buda i është përgjigjur me këshillimin: “Kujdes djalë, se të ikën koka”! (Se këtë fat pati edhe Milam Shuflai për veprën “Serbët e shqiptarët”).

-E tmerrshme! - Ishte Ai, i Madhi Zheji që na i pohoi me gojën e tij këto, se po ti dëgjonim nga dikush tjetër nuk do mund ti besonim dot... Dhe ja, pas afro dy dekadash këtë e pohon edhe gjuhëtar i shkrimtari i njohur Albert V.Nikolla në një intervistë për “NACIONAL”.

ZOTËRUESI I DHJETË GJUHËVE TË HUAJA, STUDIME TË THELLUARA NË FUSHËN E GJUHËS SHQIPE

Profesor Petro Zheji, pas vendosjes së demokracisë emigroi për shumë vite në Amerikë, SHBA, ku, në sajë të zotërimit të mbi dhjetë gjuhëve të huaja, i thelloi

e i zgjeroi edhe më shumë studimet e tij në fushën e Gjuhës Shqipe. Gjatë kohës në SHBA kemi pasë letërkembime të vazhdueshme me të.

Si u kthye, u vendos në një shtëpi me qera, se të vetën ia kishte zënë një person, të cilit ia kishte lënë në përkujdesje, por ai e kishte privatizuar për vete. Qe konstitucionalisti i mirënjohur Halil Kopani që e ndihmoi me anë të gjykatës që ta merrte përsëri shtëpinë e vet.

Asokohe ai mundi ta botojë me shpenzimet e veta librin “Shqipja dhe Sanskritishtja”, në dy vëllime. Sapo doli në qarkullim përnjëherësh disa i blenë librat e tij, por nuk po gjëndeje më në shitje. Si e mësoi këtë fakt Petroja një ditë futet në librari për të parë se si po shkonte shitja e librit dhe, nëse ishin mbaruar të çonte të tjera.

Në librari vëren se librat mungonin të afishuara në asnjë raft. Këto i kishte heqë nga vitrina librashitësjas dhe i kish futë nën banak, duke u thënë klientëve, kur e kërkonin se “është mbarue”. Kuptohet se ajo nuk kishte as arsye, as kishte interes ta bënte këtë gjë të poshtëre me kokën e saj, por me siguri dikush tjetër, ndonjë antishqiptar e kishte kërcnuar dhe porositur që të vepronte kështu.

Dhe për më keq, nuk kemi parë deri më sot që nga autoritetet shkencore a zyrtare të larta ta përmendin a përkujtojnë të ndjerin PETRO, këtë vigan që gjithë jetën e tij ia kushtoi gjuhës sonë të bukur Shqipe. Dhe akoma për më keq, paska qenë një “akademik” kosovar, që para disa vitesh ka shkruar për veprën e Petros, duke e quajtur “vepër idioti!”. E kush pra, ky akademyth i fermentuar në shkollat antishqiptare serbo - sl-lave.... ?!

Para shtatë vitesh, prof. Petro Zheji

VEPRAT MË KRYESORE TË PETRO ZHEJIT

Përkthimet, ndër qindra shqipërime veçojmë:

1. Ringjallja – Leon Tolstoi
2. Vilet e zemërimit – John Steinbeck
3. Zoti President – Migel Asturias
4. Don Kishoti – vol i Dytë, Migel Servantes
5. Galileo Galilei – Bertold Breht

Studimet Gjuhësore:

1. Shqipja dhe Sanskritishtja – dy vëllime
2. Libri i aforizmave
3. Roli mesianik i gjuhës shqipe

(1929-2015) botoi pjesën e dytë e veprës “Shqipja dhe sanskritishtja”, e cila u mirëprit nga personalitete të botës akademike, ndërsa çuditërisht u shoqërua me heshtje nga Akademia jonë e Shkencave. Gjithsesi ja vlen të nënvizojmë përfundimin në të cilin Zheji arrin me këtë të studim se: “Sistemi leksikor i gjuhës shqipe është më i gjerë nga ai i gjuhës sanskritishte, e pra ai e përfshin atë në sistemin e gjuhës sanskritishte që është një nënbashkësi e bashkësisë së sistemit të gjuhës shqipe. Përfundim ky që e shtyn Zhejin të deklarojë se është konform frymës së Rilindasve tanë mbi gjuhën shqipe, sepse saktëson vizionin e tyre profetik mbi një lashtësi zanafillore të gjuhës dhe popullit tonë.

Dy pjesët e kësaj vepre janë kurrar dhe shoqëruar me parathënie të të afërmeve të Zhejit, Gjergj Zhejit dhe Lluqa Qafokut. I pari e mbron këtë vepër kështu: “Analizat filozofike-logjike-etimologjike në këtë studim janë plotësisht të justifikuar nga pikëpamja e Dijes së kohës sonë, ndonëse jo nga ajo e gjuhësisë klasike, ku kanë ngecur ende të gozhdur mjaft gjuhëtarë”. Ndërsa i dyti e sheh si zbulimin e një teknologjie sui generis, për t'i bërë operative në fushën e etimologjisë, zbulimet gjeniale të teorisë së shenjës dhe të kuptimit të linguistikës moderne. Zbulim ky sipas Qafokut që nuk del jashtë kuadrin të përpjekjeve që kanë nisur prej fillimit të shekullit XX e që i

(Vijon në faqen 15)

KONFERENCA SHKENCORE

Sami Frashëri ideologu i shquar i Rilindjes Kombëtare

Muharem Kamani

Në mbasditen e datës 24 Maj 2024, në sallën e madhe të konferencave të QKMF "Odise Paskali" Përmet, u zhvillua konferenca shkencore në nderim të rilindasit të shquar Sami Frashëri, në 120 - vjetorin e ndarjes së tij nga jeta. Kjo konferencë u organizua nga ShAK "Vëllezërit Frashëri" e Bashkia Përmet, nën kujdesin dhe në bashkëpunim me KGjBB Tiranë e Institucioneve të tjera shkencore të vëndit. Morën pjesë qytatarë, studjues e krijues nga Përmeti dhe krahinat e tjera të vëndit e të hapësirës mbarëkombëtare.

Veprimtarinë e hapi moderatorja Kozeta Jashari me një fjalë përshëndetëse e mirseardhje, emocionuse.

Kumtesën me temë: "Frashëri dhe Dangëllia djepi i kulturës kombëtare" e mbajti Tomorr Kotorri. Ai e vlerësoi këtë konferencë një kontribut me vlera të gjithanëshme në interes të kulturës



kombëtare për të njohur brezat e sotshëm e të ardhshëm historinë e kombit dhe kontributin e burrave të shquar të

kombit tonë me të cilët duhet të krenohemi.

Dervish Hazar Cakranj e Xhemil Pa-

cani përshëndetën në emër të Kryegjyshit Botëror të Bektashinjëve, Haxhi Dede Edmond Brahimaj. Ata vlerësuan fuqinë mendore të Sami Frashërit si të një profeti.

Kryetaria e Bashkisë Përmet, Alma Hoxha i uroi konferencës punë të mbarë duke i bërë homazh dhe lartësuar emrin e Sami Frashërit në këtë 120 - vjetor të vdekjes së tij, në ditën naimiane që përkon me 178 -vjetorin e lindjes së tij, poetit kombëtar të shqiptarëve dhe ideologut të ideologjisë kombëtare. Të jemi të bashkuar në aktivitete dhe në mendime .

Aktori Xhevat Limani kishte ardhur nga ShBA për këtë event. Interpretimi i tij me nivel të lartë aktoresk elektrizoi sallën e konferencave me zërin e tij magjik.

Prof.Dr.Sherif Bundo u ndal tek mendimi filozofik i Sami Frashërit si dijetar i përmasave europiane, duke evidentuar qëndrimin e tij ndaj punës dhe njerëzve. Ai perifranoi Sami Frashërin që thotë: "Mos u bëni makutër.. Kush do të bëjë shumë punë për njëherë nuk bën asnjë. Nuk bëhen punë të mëdha me njerëz të vegjël. Dita është e shkurtër..." Prof. Budo tha se Sami Frashërit duhet ti referohet çdo pushtetar dhe ta ketë atë pasqyrë në punën e tij të përditshme.

Kumtesën e përgatitur nga Prof. Dr Albert Frashëri "Një vështrim kritik për librin e Thoma Frashërit për Frashërin dhe frashëllinjtë" e lexoi Kozeta Jashari.

Prof. Dr. Qerim Kastrati kumtoi: "Qielli, toka, burimet dhe mendimet paqësore të Sami Frashërit", duke ju referuar dy veprave të tij shkencore të cilat në disa kopje ja dhuroi disa pjesëmarrësve dhe Bashkisë Përmet.

Studjuesi Nuri Çuni u ndal në idetë kryesore të Sami Frashërit për besimin fetar tek vepra "Shqipëria ç'ka qënë, çështje dhe çdo të bëhet". Ai theksoi se besimi sjell qetësi, largon stresin dhe të bën paqësor.

Prof. Dr. Fatos Rushiti nga Kumanova që përshëndeti te pranishmit dhe personalitetet dhe në emër të klubit letrar "Jehona e Karadakut" u ndal gjerësisht tek gramatika e gjuhës shqipe me argumenta shkencore dhe foli shkurt, por me ide e kuptim të madh.

Poeti Lumo Kolleshi kumtoi temën "Sami Frashëri dhe bota perse".

Prof.Dr.Shyqyri Hysi mbajti kumtesën: "Frashëri shkollë e madhe kombëtare" ndërsa sot Baba Hekuran Nikollari e ka shndëruar në shkollë të kohëve moderne Teqene e Frashërit dhe te Alipostivanit.

Studjuesi Kujtim Mateli ju referua veprës enciklopedike me 6-vëllime të Sami Frashërit.

Të pranishmit ndoqën me interes edhe përshëndetjet nga \i dhe Prof. Dr. Hulusi Hako, Studiuesi Kujtim Boriçi, Sunaj Ramini etj.

Konkluzionet e kësaj konference i bëri kryetari i Sh.AK "Vëllezërit Frashëri", Tomorr Kotorri i cili falënderoi të pranishmit për vëmendjen që treguan dhe referuesit për prurjet e reja për zhvillimin me sukses të saj.

PETRO ZHEJI: "SHQIPJA ËSHTË MËMA E TË GJITHA GJUHËVE"

(Vijon nga faqja 14)

shohin problemet e origjinës së fjalës, edhe nga pikëpamja logjike dhe psikologjike.

Vepra e tij, siç e quan përmbledhësi dhe redaktori i librit të fundit të Petro Zhejit, Albjon Bogdani, është një diamant që shihet në të gjitha dimensionet e tij, dhe me studimet e kryera prej profesorit, ta shohësh diamantin në përsosmërinë e tij.

Vepra e Petro Zhejit për kritikën është një monument mendimi shkencor dhe akademik, mes dialogimeve të historisë dhe filologjisë, filozofisë dhe matematikës, simbolikës dhe kozmogonisë, religjionit dhe interpretimeve transhedentale.

PETRO ZHEJI: "GJUHA SHQIPE ËSHTË GJUHA E ZOTIT"

Gjatë një bisede me dishepujt e tij Rudina Robertsen dhe Afërdita Zaja, këta të fundit kanë vlerësuar se "Petro Zheji është i vetmi që ka vërtetësuar shkencërisht rolin mesianik të Shqipes si edhe lashtësinë e padiskutueshme të saj duke e vendosur gjuhën Shqipe në një rang të vërtetë Superior karshi gjuhëve të tjera të botës".

Dhe nëse për poetin, prozatorin dhe analistin e mirënjohur Preç Zogaj, "Petro Zheji është një magjepsje", Astrit Cani vlerëson se "Shkenca është arti i Petro Zhejit". Kjo sipas tij për faktin se "vepra përthimore e Zhejit, mbetet një etalon i matunisë, duke qënë Zheji artisti i matun dhe njeriu me formim të mirëfilltë shkencor, që e ka rrokë artin si mbishkencë, por ruen të paprekun higjienën mendore të intelektualit të mbrujtun me logjikë."

Ndërsa Përparim Kabo, referuar Petro Zhejit që shkruan se "Gjuha shqipe është gjuha e zotit", vlerëson se punimet e tij dallojnë për një metodologji krejt ndryshe prej asaj klasike që merret me analizën e formës së fjalës dhe strukturën e saj gramatikore.

"Në punimet e tij, studiuesi Petro Zheji merret me gjenezën historike dhe me evoluimin historik të gjuhës si mendim dhe si fjalë, pra ai e nis studimin të përmbajtja e fjalës dhe kështu në këtë rrugëtim ai zbulon veçoritë e shqipes dhe kontributin e saj në raport me gjuhët e tjera. Duke ndërtuar algoritmin e gjuhës shqipe, Petro Zheji e identon disa nga tiparet unikalë të shqipes si një gjuhë primordiale dhe rëndësinë e saj në lëmenjtë e gjuhësisë botërore", vlerëson Përparim Kabo.

Studiuesi, hulumtuesi, përkthyesi, ndër njohësit më të mirë të shqipes Petro Zheji, pas largimit e tij nga jeta më 14 mars 2015 ka lënë shumë kryevepra por është "Shqipja

dhe sanskritishtja" kryevepra e tij dhe pasuria më e madhe që i ka lënë brezave të rinj.

"Misioni i tij kishte zënë rrënjë që në barkun e nënës, - si thotë vetë Petro", - shkruan Përparim Kabo për mjeshtrin. "Do të argumentonte se, cila është gjuha shqipe? Sa e vjetër? Ku i ka rrënjët? Sa paradoksale është ajo në shprehjet e saja idiomatike? Dhe për pasojë, sa moderne dhe pashtershme është shqipja? Ca e shihnin me habi, ca me mëshirë, ca e quanin misionhumbur dhe ca pseudo e quanin "të marrë", që merrej me një punë të kotë, sepse sipas tyre, këto gjëra për shqipen i kishin thënë të tjerë dhe se çështja e shqipes ishte e zgjidhur. Ajo ishte një gjuhë indoeuropiane, dihej se në cilin grup identifikohesh dhe se sa e vjetër ishte, dhe sa e si ngjasonte dhe ku dalonte nga gjuhët e tjera".

Këze Kozeta Zylo, një tjetër studjuese e veprës së gjuhëtarit të mirënjohur shprehet se 36 gërmat e Gjuhës Shqipe vijnë si vetëtima drite nga sytë e prof. Petro Zhejit. Pikërisht nga kjo optikë shkruan përparim Kabo për mjeshtrin. "Do të argumentonte se, cila është gjuha shqipe? Sa e vjetër? Ku i ka rrënjët? Sa paradoksale është ajo në shprehjet e saja idiomatike? Dhe për pasojë, sa moderne dhe pashtershme është shqipja? Ca e shihnin me habi, ca me mëshirë, ca e quanin misionhumbur dhe ca pseudo e quanin "të marrë", që merrej me një punë të kotë, sepse sipas tyre, këto gjëra për shqipen i kishin thënë të tjerë dhe se çështja e shqipes ishte e zgjidhur. Ajo ishte një gjuhë indoeuropiane, dihej se në cilin grup identifikohesh dhe se sa e vjetër ishte, dhe sa e si ngjasonte dhe ku dalonte nga gjuhët e tjera".

Nëse akademikë dashakeqas të vendeve fqinje (serbë, maqedonas, grekë etj) janë munduar ta varrosin përfundimisht gjuhën Shqipe sepse kanë kuptuar që gjuha Shqipe është gjuha e parë Evropiane dhe që ajo qëndron në themel të krijimit të gjuhëve të tyre, profesor petro Zheji ka provuar shkencërisht se Gjuha Shqipe është një pasuri kombëtare dhe një thesar apo vlerë botërore dhe një gjuhë, e cila po lulëzon çdo ditë dhe më shumë. Për faktin se trumbetat e gjuhës Shqipe po bien sot dhe po dëgjohen kudo në çdo vend të botës, studjuesi Stiljan Dedja me të drejtë vlerëson se kjo meritë i takon veçanërisht atij që zbuloi mekanizmin e funksionimit të Gjuhës tonë të vjetër dhe të bukur, gjigandit Petro Zheji.

Për një njohës të gjuhëve si profesor Zheji, shqipja është e aftë ta kapërcejë kufirin nga një gjuhë në tjetrën... Rrugëtimin e nis nga sanskritishtja, të cilës duke e krahasuar me shqipen e ka sjellë në dy vëllime në punët e tij më të hershme.

**** Bashkëautorët Meçi dhe Rama janë skrimtarë të njohur, të dekoruar nga Presidenti i Republikës me titullin "Mjeshtër i Madh"**

SPECIALE

Arkivi Qendror Shtetëror festoi 75-vjetorin e krijimit

Begaj: Një institucion që jo vetëm ruan, por edhe frymëzon e promovon

Klotilda Saracini - ATSH

TIRANË, 7 qershor/ATSH/ - Arkivi Qendror Shtetëror festoi 75-vjetorin e krijimit, ku u prezantuan proceset e punës së përditshme në arkiv.

Në ceremoninë e organizuar ishin të pranishëm Presidenti Bajram Begaj, Kryetarja e Kuvendit, Lindita Nikolla, Drejtori i Përgjithshëm i Arkivave, Ardit Bido, arkivistë dhe studiues të fushës, etj. Presidenti Bajram Begaj në fjalën e tij theksoi rëndësinë që ka ky institucion për ndërgjegjen kombëtare dhe kujtesën kolektive, ndërsa arkivistët i cilësoi si rojtarë të historisë.

Begaj e konsideroi po aq historik edhe aktin e themelimit të Arkivës Shtetërore, duke theksuar vlerën e dokumenteve dhe materialeve të rralla, si dëshmitarë të lidhjes me lashtësinë dhe me traditën e vendeve të tjera evropiane.

Sipas Presidentit të Republikës, promovimi dhe aksesimi në thesaret e Arkivit Shtetëror është me rëndësi për të njohur në mënyrë objektive të kaluarën tonë.

“Studimi i tyre nga ekspertët dhe historianët na ndihmon të kuptojmë rrënjët tona, të vlerësojmë përpjekjet e brezave të mëparshëm dhe të ndërtojmë një të ardhme më të mirë mbi këtë bazë të fortë”, tha Begaj.

Kreu i Shtetit përgëzoi arkivistët shqiptarë që me përkushtimin dhe dedikimin e tyre, kanë bërë të mundur dokumentimin dhe ruajtjen e fondit, ndërsa theksoi se paralel me këtë angazhim, një rëndësi themelore ka shërbimi publik, që garanton një të drejtë themelore të njeriut: ruajtjen e dokumentacionit të jetës e të punës.

“Arkivat duhet të jenë të hapura, publike dhe transparente, natyrisht brenda hapësirës që lejon legjislacioni dhe etika. I kemi ende të freskëta në kujtesën tonë dëmet e pallogaritshme që pëson individi e shoqëria kur arki-



vat mbulohen nga fshehtësia apo aksesimi i privilegjuar. Arkivi Qendror Shtetëror duhet të jetë një institucion që jo vetëm grumbullon e ruan, por edhe frymëzon e promovon diversitetin, aksesueshmërinë dhe transparencën për publikun”, u shpreh Begaj.

Kryetarja e Kuvendit, Nikolla në fjalën e saj tha se “Arkivi i Shtetit është një institucion që dokumenton, shërben, ofron, sugjeron, bind e frymëzon. Në Arkiv gjejmë historinë me të gjitha kulmet e përditshmërinë e saj. Burimet arkivore janë prova e historisë sonë, dëshmuar e vlerave kombëtare e shoqërore të shqiptarëve, humanizmit, tolerancës fetare, solidaritetit njerëzor, kontributeve të shqiptarëve jo vetëm për, por edhe për të tjerët, për paqen, lirinë, mbështetjen e komuniteteve apo popujve në vështirësi”.

“Teknologjitë bashkëkohore në ruajtjen e dokumentacionit dhe modernizimi i shërbimeve arkivore i kanë bërë

arkivat shqiptare një institucion modern, dinjitoz, të admiruar e të vlerësuar, jo vetëm nga ne, shqiptarët, por edhe nga institucionet dhe agjencitë partnere.

Arkivi u shërben të gjithëve, nga institucionet qendrore të shtetit, te qytetarët e thjeshtë.

Mirënjohje, në emër të Kuvendit, drejtuesve dhe punonjësve të Arkivit për kontributin dhe shërbimet ndaj institucioneve, studiuesve dhe qytetarëve”, tha Nikolla.

Drejtori Bido e vuri theksin në fjalën e tij tek dobiet e procesit të digitalizimit të dokumenteve, që krahas ruajtjes së lëndës arkivore, bën të mundur aksesin e barabartë të qytetarëve në informacion, pavarësisht vendodhjes.

“Nëse do të shohësh gjendjen reale të një vendi duhet të shohësh pasqyrën e vet, vendin ku ruhen aktet administrative. Ndaj, nuk është rastësore që arkivi ka kaluar fazat e veta.



Mosekzistencën fillestare, mbylljen totale gjatë regjimit komunist dhe një kalim të ngadaltë drejt konsolidimit pas viteve 1990. Sikurse Shqipëria, edhe Arkivi në vitet e fundit është në rrugën e konsolidimit total, duke vijuar përpjekjet e nisura më herët. Nëse në vitin 2018 kishte 500 mijë dokumente të skanuara, sot ka 15 milionë në vetëm pak vite. Ky proces digitalizimi ka bërë të mundur që të shmangim shërbimin e lëndës arkivore në original për studiuesit dhe të shtojmë mundësitë e shërbimit të dokumenteve edhe jashtë, pavarësisht vendit se ku studiuesi ndodhet. Sot kemi nga Haniaja në Kretë e deri në Mitrovicë dhe nga Palermo e Cosenza e arbëreshëve deri në Manastirin e Alfabetit, nga Saranda deri në Istog, sallat tona të studimit. Aktualisht janë mbi 60 salla studimi të hapura në Ballkan dhe në Italinë e Jugut, që mundësojnë shërbimin e lëndës arkivore njësoj si në Sallën e Studimit në Tiranë”, tha Bido.

Në vijim të fjalës së tij, Bido u ndal tek investimi në ndërtimin e vendruajtjeve të dokumenteve në kushte optimale dhe në përpjekjet e DPA-së për të lëvruar arkivistikën si shkencë më vete.

“Në vitin 2020 ne përruam Vendruajtjen e re në Shkozë, teksa jemi duke përmirësuar kushtet e dy ndërtesave të tjera ekzistuese të përshtatura si ndërtesa arkivore. Kemi restauruar po ashtu ndërtesat në Elbasan, Lushnje, Durrës dhe Rrëshen. Prej vitit 2017, në bashkëpunim me Agjencinë Shtetërore të Arkivave të Kosovës, si edhe me Institutin për Trashëgiminë Kulturore dhe Shpirtërore të Shqiptarëve në Shkup, si edhe me institucione akademike, kemi arritur të organizojmë çdo vit Konferencën Mbarëkombëtare të Arkivistikës dhe të publikojmë revistën e përbashkët unike në shqip mbi arkivistikën. Po ashtu, DPA-ja publikon regullisht botimet e saj. Ky nuk është një bilanc, por është mishërimi në vepra i vizionit me të cilin vijum punën e brezave të mëparshëm të arkivistëve”, tha Bido.

Presidenti Begaj dhe Nikolla të shoqëruar nga drejtori Ardit Bido, bëri një vizitë në Drejtorinë e Përgjithshme të Arkivave, ku pa sallën e studimit të arkivës.

Kreu i Shtetit pasi vizitoi investimet e reja si muzeun arkivor, atë digital dedikuar të rinjve me synim njohjen e tyre me arkivën, përgëzoi drejtorin Bido për vullnetin, përkushtimin dhe profesionalizmin në transformimin e institucionit.

